

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7663 E enjte 27 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Në fund të shekullit XX Ken Robinson, një reformator i njohur në fushën e edukimit, hodhi disa ide që do të tronditnin filozofinë e edukimit tradicional në botën ...
Vijon në faqen 20

Nga SHEZAI RROKAJ

Reforma fasadë e shkollës digjitale shqiptare



Opinion i Ditës

Më 27 - 29 shtator, Presidenti i Turqisë Erdogan do të jetë për një vizitë zyrtare në Berlin, me ftesë të homologut gjerman Frank - Walter Steinmeier ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE

Pse Erdogan pritet me "pompë" në Berlin?



Presidenti në pritjen e homologut amerikan

Ilir Meta takon Donald Trampin në SHBA: Partneritet i fortë strategjik

Kreu i shtetit takon kryeministrin Xhusepe Konte: Mirënjohje për asistencën italiane

DARINA TANUSHI

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë dje në pritjen e organizuar nga Presidenti i SHBA-ve, Donald Tramp. Ata kanë realizuar edhe një foto së bashku, pas takimit. Vetë Presidenti Meta shkroi në rrjetin social ...
Në faqen 5


INTERVISTA/ OFICERI I POLICISE: KANOSJA NGA VELLAI I DEPUTETIT RRAHMAN RRAJA

"ME VUNE ARMEN NE KOKE NE SY TE TAULANT BALLES"

Reagon Taulant Balla: Shpifje e PD. Policia: Atë ditë s'ishte fare në detyrë. Emiljano Nuhu braktis policinë: Rexhep Rraja përdhunoi një vajzë, u lirua



(Në foto) Deputeti i PS, Taulant Balla. Gazetari Basir Çollaku gjatë intervistës me oficerin e policisë, Emiljano Nuhu



NATALITETI

Edi Rama premtion shpërblim 40 mijë lekë të reja për fëmijën e parë

Në faqen 7

RREFIMI NE GJYKATE

"Trafikojta drogë për llogari të grupit që kishte në krye një polic"

Në faqen 8

STUDIMI

Aleksandër Meksi: Principata arbanense dhe grindja për kufijtë e Lezhës

Në faqen 18-19

VENDIMI

28 aksione kundër kanabisit, gjykata jep 42 vite burg për 10 kultivuesit

Në faqen 9

INTERVISTA



Edmond Spaho: Nuk ka përplasje Idrizi-Dule në koalicionin tonë

Në faqen 6

Raundi i dytë i regjistrimeve, lista e plotë me 784 studentët e rinj

Emrat e fituesve në Universitetin Bujqësor

Kush vazhdon studimet në Financë, Ekonomiks dhe Informatikë Biznesi

NGA VOLTIZA DURO

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka shpallur emrat e fituesve që aplikuan në raundin e dytë të një nga programet e studimit në këtë institucion të arsimit të lartë për vitin e ri akademik 2018-2019. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot emrat



e 784 maturantëve fitues në 21 degët e universitetit, ku secili mund të verifikojë nëpërmjet ID përkatëse, numrin e pikëve të grumbulluara, në bazë të kriterëve të përcaktuara. Respektivisht në degën Ekonomiks i Aplikuar janë shpallur 3 fitues; në Ekonomik ...
Në faqen 10-11

DENONCIMI I POLICIT

INTERVISTA

Emiljano Nuhu: Më vunë pistoletën në kokë brenda në zyrat e policisë

Basir Çollaku

Oficeri i policisë në Fushë-Krujë, Emiljano Nuhu ka akuzuar vëllain e deputetit të PS-së, Rrahman Rraja se i ka vendosur pistoletën në kokë brenda në zyrat e policisë, në prani të deputetit të PS-së, Taulant Balla. Efektivi Nuhu ka folur rreth hetimit të zhvilluar nga ai për përdhunimin e Xhensila Malokut nga djali i deputetit të PS-së, Rrahman Rraja. Në intervistën e transmetuar në "Shikaj TV", Nuhu ka treguar se kreu i grupit parlamentar të PS-së, deputeti Taulant Balla ka ardhur e ka liruar nga Komisarati i Fushë-Krujës djalin e deputetit, ndaj të cilit ishte prerë fletë arresti.

Nuhu ka treguar gjithashtu edhe se vëllai i deputetit i ka vënë pistoletën në kokë, ndërsa deputeti Taulant Balla i ka thënë me ironi: "Hiqe pistoletën nga koka se oficeri është djalë i mirë dhe gjithçka që ka ndodhur do të mbesë këtu".

Emiljano Nuhu: Në 21 korrik të vitit 2018 nisi e gjithë historia. Kur shtetasja Xhensila Maloku nga zona e Niklës së Fushë-Krujës ka shkuar në komisaratin numër 3 për të kallëzuar shtetasin Rexhep Rraja.

Gazetari: Dhe objekti i kallëzimit?

Emiljano Nuhu: Pasi ky shtetas në datën 19 korrik 2018 rreth orës 17:30 e ka parë këtë shtetasë duke kaluar tek vendi që quhet Ura e Gjolës në Nikël në zonën e Fushë-Krujës, ku e ka ndaluar, e ka marrë me forcë dhe e ka futur tek makina e tij. Gjatë kohës që kanë qenë në hotel, ky shtetas ka mbushur pistoletën dhe ia ka vënë në pjesë të ndryshme të trupit shtetasës Xhensila Maloku, duke thënë që do të vras tani në qoftë se ti nuk bën marrëdhënie seksuale me mua. Nga dhuna që i është ushtruar kësaj shtetasë i ka rënë të fikët dhe akti seksual nuk është kryer.

Gazetari: Nuk është ecur ngjarjet?

Emiljano Nuhu: Këtë veprim ky shtetas, Rexhep Rraja, e ka kryer në mënyrë përsëritur brenda një periudhë njëvjeçare. Nuk është veprim i parë.

Gazetari: Pra, e ka bërë edhe disa herë të tjera?

Emiljano Nuhu: Disa herë ky problem. Kjo shtetasë ka shkuar në disa komisarate për të bërë kallëzim, por nuk është marrë kallëzim nga oficerët e policisë gjyqësore për shkak të ndikimit dhe influencës së madhe që ka pasur babai i tij, i Rexhep Rrahjes, që është

"Djali i deputetit dhunoi vajzën, Taulant Balla e nxori nga qelia"

Nënkomisari: Prokurorja më kërkoi ta arrestoja



Gazetari Basir Çollaku

të deputeti i Partisë Socialiste në zonën e Krujës dhe miqve të tij si Taulant Balla dhe kryetarit të Bashkisë së Krujës i Partisë Socialiste, zoti Artur Bushi kanë bërë të mundur që kjo shtetasë, Xhensila Maloku para Vitit të Ri, ose në fund të vitit 2017 ka shkuar për të bërë kallëzim në komisaratin numër 6 në Tiranë për të njëjtën gjë. Vajti të komisarati numër tre për të treguar ngjarjen në datën 20, për të kallëzuar ngjarjen që ka ndodhur në datën 19 korrik të 2018. Dhe aty kanë shkuar shumë shpejt, janë njoftuar nga oficerët e policisë gjyqësore që kanë qenë prezent, deputeti Rrahman Rraja, djali i tij Rexhep Rraja, shtetasi Xhelal Rraja, i cili është vëllai i deputetit dhe persona të tjerë që kanë shkuar. Në prani të oficerëve e kanë marrë shtetasën Xhensila Maloku e kanë nxjerrë përjashta, aty e ka futur në makinë djali i tij, Rexhep...

Gazetari: E kanë marrë nga policia dhe e kanë futur në makinën e tyre?

Emiljano Nuhu: Po, e kanë futur në makinën e tyre. Këto janë sipas kallëzimit dhe deklarimeve të Xhensilës.

Gazetari: Të kallëzueses...

Emiljano Nuhu: Po. E kanë futur në automjetin e tyre dhe gjatë kësaj kohe Rexhepi ka ushtruar presion që nuk do të japësh kallëzim se unë do të vras. I ka nxjerrë një pistoletë mod-

el "TT", ku ia ka vendosur në bark. I ka thënë do të vras në qoftë se jep kallëzim se na more në qafë. E ka bindur gjatë kësaj kohe që të mos jepte kallëzim...

Gazetari: E ka kërcënuar me pistoletë...

Emiljano Nuhu: Po, me pistoletë, e ka bindur në kërcënimin e armës, e ka detyruar. E gjendur në ato kushte është detyruar që të mos japë kallëzim. Dhe pas datës 20, ajo ka shkuar përsëri në datën 21, është ngritur që në mëngjes dhe ka shkuar për ta ribërë kallëzimin.

Gazetari: Ku?

Emiljano Nuhu: Në komisaratin numër 3. Pasi ka deklaruar nuk kisha besim të vija në Komisaratin e Policisë së Krujës për të dhënë kallëzim, as në stacionin e Policisë Fushë-Krujë, pasi kam vajtur e gjakosur dhe nuk ma ka marrë njeri kallëzimin. Nuk kishte besim. Dhe ka shkuar të komisarati numër 3. Mbas shumë përpjekjeve, oficerët e policisë gjyqësore që kanë qenë atë ditë, në datë 21 korrik 2018, e kanë marrë kallëzimin dhe deklarimin siç e ka shpjeguar e dëmtuara me detaje dhe për moskompetencë, për shkak se ngjarja ka ndodhur në zonën e Fushë-Krujës, ia kanë nisur me e-mail kallëzimin Komisarati të Policisë Krujë.

Gazetari: Dhe kush ishte prokurori i gatshëm të lutem?

Emiljano Nuhu: Ka qenë Mirela Kapo.

KARRIERA E EMILJANO NUHUT

"Kam rreth 10 vjet në Policinë e Shtetit dhe mbaj aktualisht gradën e nënkomisarit. Në vitin 2017-2018 kam punuar si oficer i Policisë

Gjyqësore në stacionin e policisë Fushë-Krujë. Deri në datën 15 gusht me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, zotit Ardi Veliu unë jam transferuar brenda ditës në drejtorinë e Beratit", vetëpërzotohet Emiljano Nuhu.

Gazetari: Keni biseduar me prokuroren për rastin në fjalë?

Emiljano Nuhu: Po, për rastin në fjalë ku ia kam shpjeguar me detaje dhe më ka thënë pyete djalin e deputetit, Rexhepin dhe më njoftuam, mos bëj asnjë veprim pa më njoftuar mua. Dhe unë i kam marrë deklarin, ndaj të cilit zhvillohen hetimet shtetasit Rexhep Rraja për veprën penale "Përndjekje"...

Gazetari: Çfarë tha prokurorja?

Emiljano Nuhu: Më tha, në qoftë se nuk do të japë shpjegime, nuk ka problem, bëj të ditur personit se do të arrestohesh dhe të njoftoj një avokat që të jetë prezent për procedurë.

Gazetari: Ndërkohë, prokurorja a e lëshoi urdhrin e arrestit?

Emiljano Nuhu: Ishte në gjendje të flagrancës dhe për veprat penale që ky shtetas kishte kryer nuk ka nevojë për urdhër. Bëhet me iniciativë...

Gazetari: Në kushtet e flagrancës?

Emiljano Nuhu: Po, në kushtet e flagrancës, nuk ka kaluar flagrant, është brenda ditës dhe vazhdon ndjekja dhe hetimet, nuk ka ndërprerje dhe nuk ka nevojë për të nxjerrë urdhër arresti ose urdhër ndalimi.

Gazetari: Dhe i komunikuat që do të ndalohej dhe të njoftonte avokatit?

Emiljano Nuhu: Po, i kam komunikuar që ti sot

do të arrestohesh për këto vepra penale dhe do të njoftosh avokatit. Në rregull më tha. Kam marrë në telefon babain e tij, shtetasin Rrahman Rraja, ku i kam thënë hajde në stacionin e policisë në Fushë-Krujë se kam një problem. Për rreth 30 minuta ka ardhur aty prezent babai i tij, te zyra ime, Rrahmani i cili është deputet i Partisë Socialiste, i shoqëruar nga kryetari bashkisë Artur Bushi, i shoqëruar nga deputeti Taulant Balla që është kryetar i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, i shoqëruar edhe nga vëllai i tij Xhelal Rraja.

Gazetari: Në cilën datë kanë ardhur...

Emiljano Nuhu: Ata kanë ardhur në datën 21 korrik të vitit 2018, rreth orës 19:30 në zyrën time.

Gazetari: Pra, kanë ardhur këta persona që ju përmendët?

Emiljano Nuhu: Po, personat që përmenda më sipër.

Gazetari: Balla dhe Bushi pëse erdhën. Mirë babai deputeti...?

Emiljano Nuhu: Nuk e di, ishin aty shumë shpejt, janë shumë miq, kanë lidhje miqësore shumë të ngushtë me deputetin e Krujës. Erdhën në zyrën time, nuk kam arritur ta mësoj se si erdhën aq shpejt në zyrën time.

Gazetari: E kuptoj. Erdhën këta persona, po persona të tjerë që i shoqëronin kishte?

Emiljano Nuhu: Kishte nja 10 persona që i shoqëronin, këta qëndruan në ambientet e poshtme të korridorit të komisarati, të stacionit të policisë së Fushë-Krujës se quhet stacion, jo komisarati.

Gazetari: Po këta persona çfarë ishin, këta të 10 që i shoqëronin?

Emiljano Nuhu: Nga informacioni që mora nga punonjësit e policisë, i njihnin si element të precedentë kriminalë të zonës, të një grupi kriminal shumë të fuqishëm në zonën e Niklës. Këta qëndruan në ambientet e stacionit, nuk u futën në zyrë, vetëm personat e lartpërmendur u futën në zyrë. Gjatë kohës që u futën këta,



unë isha në zyrë me shtetasin Rexhep Rraja, ishin dy punonjësit e patrullës së përgjithshme me uniformë. Dhe në momentin që këta persona kanë hyrë, Rrahman Rraja u ka thënë punonjëseve të policisë dilni jashtë se kemi ne punë në zyrë. Unë kam ndërhyrë dhe i kam thënë që nuk pse të dalin punonjësit e policisë jashtë, të flasin në prezencën e tyre. Ua ka bërë me shenjë punonjëseve të policisë dhe kanë reaguar dhe kanë dalë përjashta për shkak të influencës që ka ai.

Gazetari: Ata janë larguar dhe në zyrë mbetët ju, 2 deputetët dhe kryebashkiaku i Krujës?

Emiljano Nuhu: Po, edhe vëllai i deputetit Xhelal Rraja.

Gazetari: Çfarë ndodhi pasi ngelët vetëm në zyrë?

Emiljano Nuhu: Pasi ngelëm vetëm në zyrë, unë i komunikova Rrahmanit, i thash që djali juaj do të arrestohet për shkak të influencës që ka ai. **Gazetari: Ju thotë juve? Emiljano Nuhu:** Po, po. "Nuk del i gjallë nga zyra në qoftë se ti arreston nipin tim". Unë, i gjendur në këto kushte i thash kam marrë urdhër nga prokurorja ta arrestoj, në të kundërt shkoj unë në burg. Me të thënë këtë fjalë, ai është i rritur jashtë mase. Shtetasi Xhelal ka kapur nipin për krahu dhe i ka thënë dil përjashta. Në këtë moment unë kam ndërhyrë dhe



Në deklaraten për me diat bërë nga kryesia e Kuvendit, deputeti Taulant Balla ka publikuar ndër të tjera letrën e dorëheqjes, që nënkomisar Emiljano Nuhu, u kishte drejtuar drejtorit të përgjithshëm të Policisë, Ardi Veliut dhe për dijeni Presidentit Meta, kryeministrit Rama dhe kryeprokurores Marku. Në letrën e cila mban datën 14 shtator 2018 edhe që mban firmën e nënkomisar Emiljano Nuhu, ky i fundit kërkoi lirin nga detyra, pas kërcënimeve sipas tij, nga persona të veshur me pushtet. Në letrë ai ka ndër-tuar skenarin e porositjes së vrasjes së tij nga deputeti Rrahman Rraja, nëpërmjet Durim Bami. "Më datë 12.09.2018, kam marrë informacion nga rrjeti im sekret që deputeti z.Rrahman Rraja ka kontaktuar me shtetasin Durim Bami dhe i ka kërkuar që të më ekzekutojë, pasi unë po i hapja shumë probleme dhe po e dëmtoja politikisht deputetin. Ai është shprehur që me kaq probleme që më ka hapur oficeri Emiljani Nuhu, unë nuk shkoj dot në parlament. Shtetasi Durim Bami e ka marrë përsipër ekzekutimin tim. I gjetur në kushte të tilla, i lënë në dorën e fatit nga shteti, u largova menjëherë dhe për sigurinë time dhe të familjes kërkoi të lirohem nga Policia e Shtetit", shkruan Nuhu në letrën e tij të dorëheqjes. Në dëshminë e tij, Emiljano Nuhu thotë se ishte ankuar tek eprorët disa herë, por gjithçka kishte rënë në vesh të shurdhër. "Mora shefin e komisarariatit tim në telefon, Artur Heba-jn. E njoftova mbi të gjithë situatën që kishte ndodhur, i thash edhe më kanosën me armë në zyrë, e morën nga zyra dhe unë ngela, nuk kisha çfarë të bëja, dua forca për të zbatuar ligjin, për të zbatuar urdhrin e prokurorit. Dua oficerë të tjerë të mi dërgosh këtu, se kanë hyrë këta shtetas dhe i tregova për shtetasit e tjerë të armatosur që ndodheshin në ambientet e jashtme të stacionit të policisë, por ai më tha merre me qetësi, mos u merrz-it se flas unë me ta'.

← i kam thënë prit të flas me prokuroren dhe pastaj merre dhe nxirre përjashta. Në këto momente ka nxjerrë një pistoletë dhe ma ka vënë në kokë dhe më ka thënë hiqi duart dhe s'do flasësh me asnjë njeri në telefon dhe këto gjëra do të mbeten vetëm këtu në zyrë, përkundrazi do të zhduk.

Gazetari: Në prani të këtyre të tjerëve që ne përmendëm?

Emiljano Nuhu: Në prani të vëllait të tij, deputetit Taulant Balla dhe kryetarit të bashkisë, dhe këta me ironi i kanë thënë hiqe pistoletën nga koka e oficerit se është djali i mirë oficeri, nuk i bën ato gabime.

Gazetari: Kush e tha këtë?

Emiljano Nuhu: Njëkohësisht e tha Taulanti me Arturin në qetësi absolute. E thanë, nuk ishin as të irrituar, asgjë. I irrituar vetëm me kërcënime ishte Xhelali, vëllai i deputetit, i cili nxori armën. Në këto kushte e hoqi pistoletën, e futi në brez dhe tha e mbyl-lëm këtë muhabet këtu dhe do të ngelet këtu askund tjetër, në asnjë moment nuk do të hapet se çfarë ndodhi këtu se ti ke...

Gazetari: Xhelali armën me leje apo pa leje e kishte meqë...

Emiljano Nuhu: E kish-te pa leje, pa leje e kishte. Edhe djali e kishte pa leje gjatë kohës që ishte në zyrë dhe këtë e deklaroi edhe personi i dëmtuar gjatë kohës që i është ushtruar person në zyrën e oficerit tjetër. Dhe në këto kushte këta dolën nga zyra ime, e morën dhe unë ngela i vetëm, nuk dija çfarë të bëja...


Gazetari: Edhe të akuzuarin e morën me vete?

Emiljano Nuhu: Po, po. Unë ngela i vetëm, nuk kisha çfarë të bëja kundër atyre personave. E vetmja rrugë ligjore që kisha unë ishte të njoftoja eprorët e mi dhe prokuroren.

Nënkomisari i policisë i dërgoi letrë Ardi Veliut: Heq dorë nga policia

Emiljano Nuhu: Durim Bami u urdhërua të më ekzekutonte

"Më 12 shtator e kontaktoi deputeti i PS"



Faksimile e letrës së Nuhut, drejtuar Ardi Veliut

C'THOTE VETE VAJZA
"E kam denoncuar Rexhep Rrajën, por nuk kam qenë e përndjekur prej tij. U takuam me të në stacionin e policisë, por bëmë muhabet normalisht. 90% e atyre që thotë Emiljano Nuhu janë të gënjeshtërt", deklaroi dje në një intervistë televizive, vajza në qendër të historisë, Xhensila Maloku.

"Më 21 korrik nuk ka qenë fare në detyrë. Po hetojmë"

Policia: Nuhu u transferua se ndihej nën rrezik, me Rrajat u takua në kafe



HETIMET E POLICISE

SHÇBA po kryen verifikim dhe hetim të thelluar për të gjitha pretendimet e ngritura nga oficeri Emiljano Nuhu në letrën e bërë publike si dhe në intervistën e dhënë prej tij. Në përfundim të këtyre hetimeve do të ketë një njoftim publik.

timin dhe materialet operative. Nga verifikimet polico-re dhe në bashkëpunim me agencitë homologe, ky shtetas ka kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme drejt Kosovës, pa u regjistruar në sistem dhe duke braktisur detyrën. Në datë 15 shtator 2018 ka udhëtuar me avionin e linjës Prishtinë-Verona, Itali. Në datë 21 korrik 2018, oficeri Nuhu nuk ka qenë fare në detyrë, ashtu siç pretendon në intervistë. I gatshëm në datën 21 korrik 2018 dhe që ka kryer vep-

rimet ka qenë një tjetër punonjës policie, me iniciale G.Ç. Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se asnjë nga shtetasit e pretenduar në deklaratim mediatike të oficerit Nuhu, se e kanë kërcënuar, nuk kanë hyrë në ambientet e komisarariatit siç pretendohet prej tij. Takimi mes oficerit Emiljano Nuhu dhe shtetasit e pretenduar R.Rr. ka ndodhur në një lokal në Tiranë. Por, nga verifikimet e kryera pas kallëzimit të bërë nga Emiljano Nuhu në Komisarariat në 6

në Tiranë dhe me pas referuar në Prokurorinë e Tiranës, rezultoi se ata njiheshim shumë më herët, që në kohën kur Nuhu ishte me detyrë në Policinë e Tiranës. Komunikimet e kryera midis tyre përmes aplikacionit 'Whatsapp' kanë qenë miqësore dhe pa kërcënime. Këto komunikime gjenden të administruara në dosjen hetimore. Gjithashtu në kallëzimin e tij, ku pretendon se është kërcënuar, Emiljano Nuhu u referohet vetëm 2 shtetasve të lartpërmendur, të cilët sipas tij, i janë prezantuar si të afërm të autorit të dyshuar që ka kryer përndjekjen, por nuk përmend asnjë prej emrave që deklaroi në intervistën në media. Emra, të cilët në asnjë rast nuk i ka përmendur në komunikimet me eprorët e tij. Pavarësisht të gjitha deklaratimeve, bëjmë me dije se Komisaritari i Policisë Krujë pas marrjes së kallëzimit nga e dëmtuara Xh.M., materialet i ka referuar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, e cila ka regjistruar procedimin penal nr. 372/2018 dhe po drejton hetimet.

mos u merrzit. Në këto kushte mbyllet telefoni. Kam njoftuar prokuroren. I kam treguar prokurorës të gjithë historinë që ka ndodhur

brenda në zyrë dhe nuk arrita dot të zbatoj ligjin i thash prej shkak të ndërhyrjes së atyre personave. Më tha merr drejtuesit e tu dhe

kërkoju ndihmë në rrugë institucionale. Unë i thash drejtuesit e mi i vura në dijeni, kërkova ndihmë por nuk më solli asnjë ndihmë, veç më

tha mos u merrzit se merremi ne me ta dhe lërë të merret oficeri Gentjan Çitozi me këtë se i ka miq shtëpie", pretendon oficeri i policisë.

SKANDALI REAGIMET

Valentina Madani

Kreu i PD: BE të reagojë, ndëshkim ligjor për pushtetarët që braktisën vajzën

Dëshmia e oficerit, Basha: Djali i deputetit kreu krim monstruoz

"Para drejtësisë të vihen Rraja, Bushi, Balla"

Kreu i opozitës, Lulzim Basha publikoi mbrëmë nga selia e PD-së videon e plotë të ish-oficerit të policisë, Emiliano Nuhu, i cili dëshmoi se si është sulmuar nga politikanët. Pas denoncimit të oficerit të policisë Emiliano Nuhu se është kërcënuar me armë për të mbyllur dosjen e djalit të deputetit të PS-së, Rrahman Rrahja, i akuzuar për përdhunimin e Xhensila Malokut, Basha e cilësoi atë një dëshmi tronditëse. Z.Basha tregoi me emra se kush duhet të dalë para drejtësisë. Rexhep Rrahja, Artur Bushi dhe Taulant Balla janë sipas Bashës, personat që qëndrojnë pas këtij skandali e për këtë duhet të dënohen. Sipas tij: "Pushetiti i bërë njësh me krimin po e trajton këtë rast si të inskenuar nga opozita". "Një vajzë e pambrojtur është dhunuar, përdhunuar, rrëmbyer dhe torturuar në mënyrë sistematike. Është një krim monstruoz, që meriton dënimin më të rëndë. Mbi të gjitha, ky është një krim shtetëror, ndaj para drejtësisë duhet të dalë jo vetëm sadisti çnjerëzor Rexhep Rraja, por edhe pushtetarët që i dhanë mbrojtjen shtetërore krimi-nelit: Rrahman Rraja, Artur Bushi dhe Taulant Balla, ky i fundit një politikan bandit i zhytur në botën e krimin", theksoi z.Basha. Sipas tij, së bashku me ta, para drejtësisë duhet të dalin të gjithë drejtuesit e policisë dhe të prokurorisë që braktisën ligjin, detyrën dhe qytetaren e pafajshme, veçanërisht ata që përndoqën, larguan dhe kërcënuan e bënë plan për ta eliminuar nënkomisarin Emiliano Nuhu, që u përpoq të luftonte krimin. Z.Basha u bëri thirrje të gjithëve qytetarëve, veçanërisht grave dhe vajzave që të mos heshtin, por të ngrenë zërin dhe të dënojnë ashpër këtë krim shtetëror ndaj një vajze të pambrojtur. Lulzim Basha apeloj për ndëshkim ligjor për pushtetarët që braktisën vajzën dhe që tentuan të eliminonin ish-policiun Nuhu. "Nëse nuk ngrenë zërin të gjithë bashkë sot, krimi nuk do të kursejë asgjë, as pronën, as jetën dhe as të ardhmen e askujt. Vetëm forca e njerëzve të bashkuar mund ta mposhtë diktaturën e krimin", theksoi kreu i PD-së. Gjithashtu, z.Basha pati edhe një mesazh për ndërkombëtarët që të mos mbyllin sytë para këtij krimin monstruoz shtetëror: "I bëj thirrje komunitetit ndërkombëtar që të mos mbyllin sytë sërisht, por të shohin nivelin alarmant të kapjes së shtetit nga krimi i organizuar, për të mos u bërë me heshtjen e tyre mundësuat e kriminalizimit të shtetit. Heshja dhe iluzionet e rreme mundësuat drogën dhe krimin në politikë: por sot kjo heshje rrezikon të çojë në përplasje shoqërore. Kur shtetini e kap krimi, qytetarëve u mbetet vetëm dhuna për të mbrojtur jetën dhe fëmijët e tyre", u shpreh kreu i opozitës, Emiliano Nuhu denoncoi disa zyrtarë të Partisë Socialiste duke thënë se i janë futur të armatosur në zyrë. Emrat që Nuhu përmendi janë deputeti Taulant Balla, kreu i Bashkisë së Krujës, Artur Bushi dhe deputeti Rrahman Rrahja.



Kreu i opozitës, Lulzim Basha

AKUZA

"Ky krim i rëndë kundër njeriut, i mundësuar dhe mbrojtur nga funksionarët më të lartë të shtetit është kambana e alarmit për të gjithë shoqërinë se tashmë jeta e çdokujt është e rrezikuar nga kriminelët e rrugës, që mbrohen nga kriminelët e shtetit", theksoi z.Basha.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dje në pritjen e organizuar nga Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump

Akuzat, Balla-Bashës: S'kam shkelur në Krujë, shihemi në gjyq

Kreu i grupit të PS, Taulant Balla, reagoi dje pas akuzave nga ana e opozitës dhe eksponentëve të saj në drejtim të mazhorancës. Ai denoncoi ekzistencën e një dëshmie, sipas tij, të rreme që po gatuhet në zyrat e PD-së, që e akuzojnë atë se ka qenë në mesin e personave që kanë kërcënuar oficerin e policisë së Fushë-Krujës, Emiliano Nuhu të mbyllte dosjen e djalit të deputetit Rrahman Rraja, i akuzuar për përdhunimin. Balla shprehet se pavarësisht asaj që e quan inskenim të PD, ai nuk ka qenë kurrë në komisariatit e Fushë-Krujës, aq më pak të ketë kërcënuar policin. Balla tha se gjatë vitit të fundit nuk kishte shkelur në Krujë dhe as në komisariatit e këtij qyteti i armatosur: "Unë e provoj lehtësisht ku kam qenë atë ditë që maskarai i paguar apo i patrup, apo të dyja bashke, ka bërë këtë letër për të përfituar azilin politik", u shpreh z. Balla pas reagimit të ashpër të kreut të PD-së. Po ashtu, ai njoftoi se të vërtetën do ta provojë në gjyqin e radhës që do të ketë me Lulzim Bashën për këtë çështje, duke bërë të ditur kështu se do ta kallëzojë penalisht. "Dhe do ta provoj në gjyqin e radhës që do të kem me Lulzim Bashën për këtë çështje. Raportet mjekësore nuk do ta shpëtojnë Lulzimn nga pasojat juridike të gënjeshtrave të tij", tha z.Balla.



REAGIMI

Hedh një i marre nje gure ne lume dhe 100 te mencur s'e nxjerrin dot, thote populli!

Por jo, kjo qe po shoh sot eshte me keq.

"Te mençurrit" e dine fare mire cfare marrezie eshte kjo shpife qe jane turrur ta pasqyrojne me nje zell te madh, vetem pasi e nxorra une vete!

Kjo sajese e ndyre dhe e verifikueshme pa veshitresi nga cdokush qe publikon lajme, ka nje qellim te qarte: Te coje uje ne mullirin e prishur te Lulzim Bashes! Une s'kam shkelur as ne Kruje gjate vitit te fundit dhe jo me ne komisariatit e Krujes i armatosur. Une e provoj lehtesisht ku kam qene ate dite qe maskarai i paguar apo i patrup apo te dyja bashke, ka bere kete letër per te perfituar azilin politik.

Dhe do ta provoj ne gjyqin e radhës qe do te kem me Lulzim Bashën për këtë çështje. Raportet mjekësore nuk do ta shpëtojnë Lulzimn nga pasojat juridike të gënjeshtrave të tij. Ndërsa disa mediave hiena qe ushqehen me mishra te ngordhur u kam lene Zotin se tjetër s'kam c'u them!



Kryemadhi: Djali i deputetit përdhunoi jetimen, ngjarje e rëndë!

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi e konsideroi skandalin ngjarje shumë të rëndë, atë që i ka ndodhur një oficeri policie gjyqësore në komisariatit e Fushë-Krujës. Sipas deklarimeve të tij, i është vënë pistoleta në kokë për të mos pranuar denoncimin e një vajze që ishte përdhunuar nga djali i deputetit socialist, Rrahman Rrahja. "Kjo është shumë e rëndë. Unë mezi pres nga këto shoqat për të drejtat e grave, të cilat bëjnë projekte pa fund, mezi po pres të shikoj gjithë ato personazhe publike që flasin në televizione ndaj dhunës ndaj grave, mezi pres deklaratat e tyre në përkrahje të kësaj vajze, e cila është jetime, e cila e ka të pamundur mbrojtjen e saj nga familjarët, e cila ka qenë viktimë e dhunës apo epshëve të një djali socialisti, më të përkëdhelur se ç'duhet. Më e tmerrshma është që pistoleta në kokë i vhihet në prezencë të kryetarit të bashkisë dhe të një deputeti, kolegut tonë. Ky vend është kthyer në një bandë", - tha Kryemadhi.



Denoncimi i ish-oficerit, Berisha: Si po manipulon policia

Ish-kryeministri Berisha komentoi dje denoncimin e oficerit të policisë së Krujës, Emiliano Nuhu si dhe reagimin e policisë për këtë ngjarje. I ftuar në emisionin "Fakt" në "Syri.net", Berisha tha se ajo është një dëshmi tronditëse dhe se ai i ka ditur faktet. Sipas ish-kryeministrit, fjalët e policisë janë të ndryshme nga ata të muajt korrik. "Sot Geron Veliu apo Ardi Xhafaj lëshoi një komunikatë ku damkos veten e tij. Në komunikatën që lëshoi në fund të korrikut për të kundërshtuar statusin tim, informon publikun se dëshmitë e vajzës u morën nga komisariatit numër 3 dhe nga oficerët e Komisariatit e Krujës dhe prokurorët. Sot faqezi Xhafaj dhe Ardi Xhafaj apo Geron Veliu deklarojnë se nuk ka qenë në komisariatit e policisë nënkomisarin Emiliano Nuhu, por ka qenë Gentian Çitozi, ndërsa 1 muaj para ish-informacionit të oficerit. Sot ishte vetëm Çitozi sepse duan të zhdukin çdo gjurmë krimi që kanë fshehur para shqiptarëve. Këtë nuk e ka bërë Ramazani që ka kërcënuar Nuhun, as ai tjetri, por këtë e ka bërë Faqezi Xhafaj që nuk ka nder, dimjtjet familje dhe asgjë, që pranon që një vajzë jetime të kërcënohet në këtë mënyrë", - tha Berisha.

“DENONCIMI

Rasti u denonca në muajin korrik nga ish-kryeministri Berisha. Referuar një mesazhi nga qytetari dixhital, Berisha akuzonte djalin e deputetit të PS-së në Krujë, Rrahman Rrahja se ka përdhunuar një vajzë dhe se policia e ka fshehur ngjarjen.



Kreu i shtetit në Nju Jork, foto familjare me Presidentin e SHBA

Meta takon Trump: Partneritet i fortë strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA

Presidenti merr mbështetjen për negociatat nga Polonia e Qipro

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë dje në pritjen e organizuar nga Presidenti i SHBA-ve, Donald Trump. Ata kanë realizuar edhe një foto së bashku, pas takimit. Vetë Presidenti Meta shkroi në rrjetin social "Facebook" pas pritjes së Trump: "I kënaqur që mora pjesë në pritjen e Presidentit të SHBA, Donald Trump. Partneritet i fortë strategjik mes Shqipërisë dhe SHBA". Kreu i shtetit ndodhet në Nju Jork, në kuadër të pjesëmarrjes në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së. Dje ai pati disa takime me personalitete botërore. Presidenti Meta u takua me Mbretin e Jordanisë, Abdullah II. Sipas njoftimit të Presidencës, ai vlerësoi marrëdhëniet shumë të mira midis dy vendeve, si dhe theksoi rëndësinë që këto marrëdhënie të marrin një hov të ri në të ardhmen. "Bashkëpunimi dypalësh, veçanërisht në fushën e sigurisë, por edhe interesi në rritje për të bashkëpunuar në aspektin ekonomik apo të shëndetësisë janë fusha që duhet t'i nxisim e promovojmë më tej", nënvizoi Presidenti Meta. Në mënyrë të veçantë Presidenti Meta vlerësoi angazhimin dhe rolin shumë të rëndësishëm që Mbretit Abdullah II dhe Jordania luajnë për paqen dhe sigurinë në rajonin e Lindjes së Mesme. Nga ana e tij, Mbreti Abdullah II e vlerësoi shumë bashkëpunimin me Shqipërinë dhe me kënaqësi pranoi ftesën e Presidentit Meta për të zhvilluar një vizitë zyrtare në Shqipëri. Në vijim të ndjekjes së punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Presidenti i Republikës, Ilir Meta, u takua me Presidentin e Republikës së Qipros, z.Nicos Anastasiades. Presidenti Meta e falënderoi homologun qipriot për mbështetjen që ai personalisht dhe Qipro i japin çeljes së negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Gjithashtu, Presidenti Meta nënvizoi interesin për t'i fokusuar më tej marrëdhëniet midis dy vendeve, veçanërisht në aspektin ekonomik dhe për t'u dhënë atyre më shumë rezultate substanciale. Në mënyrë të veçantë, Presidenti Meta nënvizoi interesin për të bashkëpunuar

ngushtë në kuadër të rajonit të euromesdheut dhe kontribuar së bashku për forcimin e paqes dhe stabilitetit në këtë rajon. Nga ana e tij, Presidenti Anastasiades e siguroi z. Meta për vijimin e mbështetjes së Shqipërisë në kuadër të BE-së, si dhe shprehu dëshirën për të shkëmbyer vizita në nivel pres-

identi në dobi të forcimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Një tjetër takim ishte edhe ai me Presidentin e Polonisë, z.Andrzej Duda. Të dy bashkëbiseduesit ndanë të njëjtin mendim lidhur me marrëdhëniet shumë miqësore e të bashkëpunimit prej dekadash mes dy vendeve dhe nevojën e forcimit dhe in-

tensifikimit të mëtejshëm të tyre në të ardhmen. Në mënyrë të veçantë të dy presidentët vlerësoan rritjen e interesit dhe të bashkëpunimit në fushën e turizmit dhe numrin gjithnjë në rritje të turistëve polakë që vizitojnë Shqipërinë. Presidenti Meta shprehu mirënjohjen për mbështetjen që Polonia i jep procesit të integritimit evropian të Shqipërisë dhe çeljes së negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Gjatë bisedës u vlerësuan edhe mbështetjet reciproke për kandidaturat e të dy vendeve në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Kreu i shtetit, Ilir Meta mori pjesë edhe në Forumin Global të Biznesit "Bloomberg 2018". Në këtë aktivitet ndërkombëtar ku marrin pjesë drejtues shtetesh dhe investitorët më të fuqishëm në botë, Presidenti Meta është takuar me Mike Bloomberg, investitorin, politikanin dhe filantropin e njohur në arenën ndërkombëtare.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dhe homologu i Qipros, Nicos Anastasiades

ATIFETE JAHJAGA

Atifete Jahjaga, ish-presidente e Kosovës ka marrë shtetësinë shqiptare. Dekreti është firmosur nga kreu i shtetit, Ilir Meta dhe sipas njoftimit të publikuar në faqen zyrtare të Presidencës, hyn në fuqi menjëherë.



Debate në Këshillin e Legjislacionit për nismën e opozitës

Ventingu në politikë, PS: Ta çojmë në "Venecia". PD: Keni siklet

Opozita dhe mazhoranca debatuan dje në mbledhjen e përbashkët të Këshillit të Legjislacionit dhe Komisionit të Ligjeve në lidhje me propozimin e opozitës për vetingun në politikë. Demokrati Enkelejd Alibeaj e ka quajtur këtë një tentativë të qartë zvarritëse të asaj që sot është emergjencë kombëtare, pastrimit të politikës përmes vetingut, njësoj si në drejtësi. Mbledhja u shoqërua me debate mes palëve politike PD-PS. Deputeti i PS-së, kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja ka theksuar se deputetët kanë të drejtën e votës për amendim të Kushtetutës, por jo të drejtën për ta shkëlur atë. Në vijim të kërkesës së PD-së, nëse do ta bëjnë apo jo vetingun në politikë, ai ka thënë se do të kërkohet opinionin i Komisionit të Venecias. Oerd Bylykbashi tha se vetingu për politikanët duhet të bëhet njësoj si për prokurorët, gjyqtarët dhe policët. Sipas tij, ekziston një listë me politikanë që jo vetëm duhet të verifikohen, por edhe t'u ndërpritet mandati për shkak të lidhjeve të tyre me krimin. Përfaqësuesi i PS-së, Ulsi Manja u shpreh se me kërkesën e tyre, deputetët e opozitës kërkojnë të shkellet Kushtetuta. Sipas tij, fillimisht duhet përcaktuar një kalendar seancash dëgjimore e më pas duhet pritur opinionin i "Venecias". "Ne kërkojmë në trajtimin e kësaj nisme respektimin e nenit 77, pika A, përcaktimin e një kalendari për seanca dëgjimore, por edhe të opinionit të "Venecias". Po kërkojmë të ndërhyjmë disa herë në Kushtetutë, që nuk mund të jetë statuti i PS apo PD. Nuk kemi nevojë për nxitim, nisma është në kalendar", tha Manja.

Bushati në OKB, agjendë takimesh dhe fushatë për Këshillin e Sigurimit

Shqipëria liberalizon vizat me El Salvadorin, nënshkruhet marrëveshja

Gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati mori pjesë në mëngjesin e punës të organizuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal në formatin e Ministrave të Jashtëm të Ballkanit Perëndimor, me pjesëmarrjen e komisionerit të BE-së, Johannes Hahn. Ministrat diskutuan mbi ecurinë e zbatimit të Zonës Ekonomike Rajonale, perspektivën e integritimit në BE të Ballkanit Perëndimor si dhe situatën politike e ekonomike në rajon. Në fjalën e tij, ministri Bushati theksoi lidhjen e drejtpërdrejtë mes konsolidimit të shtetit të së drejtës dhe mjedisit të sigurt në funksion të zhvillimit ekonomik të rajonit si dhe nënvizoi domosdoshmërinë e vullnetit politik për heqjen e barrierave që pengojnë ndër-lidhjen në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Në këtë



kontekst, ministri Bushati i kushtoi rëndësi të veçantë domosdoshmërisë së përfshirjes së gjitha vendeve të rajonit në hartën e ndër-lidhjes telefonike dhe në zbatimin e angazhimeve për hapjen e pikave kufitare e lehtësimin e lëvizjes mes qytetarëve të rajonit. Kreu i diplomacisë shqiptare risolli në vëmendje deklaratën e

Samitit të Sofjes, e cila nënvizon rëndësinë e një tregu të vetëm për Ballkanin Perëndimor. Ndërkaq, ministri Bushati ishte i pranishëm në Darkën Transatlantike të organizuar nga Sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, me ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare të NATO-s, BE-së dhe vendeve partnere. Biseda u përqendrua të çështjet e sigurisë dhe sfidat me të cilat përballen shoqëritë tona. Ministri Ditmir Bushati gjatë qëndrimit në Nju Jork zhvilloi një takim me ministrin për Marrëdhëniet me jashtë të El Salvadorit, Carlos Castaneda dhe me ministrin e Jashtëm të shtetit të Katarit, Jassim Al-Thani. Mes ministrat Bushati dhe ministrin Castaneda u firmos edhe një marrëveshje për liberalizimin e vizave për shtetasit shqiptarë. Marrëveshja ka si qëllim lehtësimin e qar-kullimit të lëvizjes ndërmjet dy shteteve.

SITUATA POLITIKE

INTERVISTA

Valentina Madani

Demokratët kur ndër morën nismën e de kriminalizimit, nuk i kishin votat për ta kaluar në Kuvend. Por pas 6 muajve, PD mundi të bindë ndërkombëtarët për nismën e saj, gjë që detyroi mazhorancën që ta votojë ligjin e dekriminalizimit. Këtë bindje kanë demokratët edhe në rastin e nismës së vetingut në politikë, që synon largimin e politikanëve të lidhur me krimin. Edmond Spaho, kreu i deputetëve të PD-së nuk ka asnjë pritshmëri pozitive nga mazhoranca dhe thotë për "Gazeta Shqiptare" se miratimi i këtij ligji rrezon gjysmën e qeverisë dhe një pjesë të mirë të grupit parlamentar, si të lidhur me krimin e organizuar. Z. Spaho flet edhe për debatin e Teatrit Kombëtar, zgjerimin e koalicionit opozitar kundër Edi Ramës, si dhe debatin për Teatrin e ri Kombëtar.

Z. Spaho, opozita ka intensifikuar qëndrimin e saj kundër qeverisë së majtë, por çfarë ndodh nëse Edi Rama vazhdon të mbajë pushtetin?

Nëse nuk do kishin besim në aksionin tonë politik, nuk do t'a kishim ndërmarrë. Largimi i Edi Ramës nga pushteti nuk është kapriço e jona, por nevojë e vendit. Sot vendi drejtohet nga krimi dhe qeverisja i shërben atij. Shikoni situatën në Shkodër, Vlorë, Elbasan, Durrës ku njerëzit vriten e zhduken si të ishte luftë. Shikoni si është katandisur Prokuroria, ku askush nuk guxon të merret me Shullazin e bandën e tij. Ermal Hoxha, i dënuar për ngritjen e laboratorit të kokainës në Xibrakë, u lirua për sjellje të mirë. Vendi është pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë. Ekonomia bën poshtë e më poshtë dhe Shqipëria po zbrazet. Edhe për 6-mujorin e parë të vitit 2018 zëmë vendin e parë për kërkesa për azil në Evropë me 8040 kërkesa. Të gjithë duhet të pyesim veten se ku po shkojmë?

Ish-kryeministri Sali Berisha është shprehur se do të ishte vetëvrasje hyrja në zgjedhje me Edi Ramën, pasi PD-ja sipas tij, nuk do t'i fitonte ato për shkak të blerjes së votave. A t'herëz si do veprojë opozita?

Edi Rama është armik i zgjedhjeve të lira e të ndershme. Ai i fiton zgjedhjet me paratë e krimit dhe përdorimin e kontingjenteve kriminale, administratës publike, policisë dhe çdo mjet tjetër, të cilin e disponon për shkak të pushtetit absolut që ka mbledhur. Opozita nuk mund të bëhet fasadë e këtij

Zgjedhjet, kreu i grupit të PD-së: Rama i fiton me paratë e krimit, s'bëhemi fasadë

Spaho: Nëse bëhet vetingu në politikë, rrëzohet gjysma e qeverisë

"Afrimi i Idrizit, asnjë çarje në koalicion"



Edmond Spaho, kreu i deputetëve të PD-së

pushteti të kriminalizuar. Në këtë rast ka vetëm një rrugë, që ai të largohet me çdo mjet të mundshëm nga qytetarët e vendit. Mendoj që është në përgjegjësinë e çdokujt, i cili ka një fije ndjeshmërie për gjendjen, përfshirë median, që të mos merremi me sofizma, por t'u bëjmë thirrje qytetarëve të reagojnë, nëse duam të shpëtojmë nga makthi që na ka mbërthyer dhe nëse duam të shpëtojmë vendin. Ndaj me Edi Ramën në qeveri, sikurse ka ndodhur në të shkuarën, nuk ka zgjedhje të lira dhe të ndershme, prandaj fokusi ynë është

gun në politikë?

Sepse gjendja është e pabarueshme. Dy ministra të Brendshëm njëri pas tjetrit të lidhur me krimin e organizuar dhe trafikun e drogës, kreu i mazhorancës në Kuvend mburret se ka miqësi familjare me një të dënuar me 21 vite burg për trafik ndërkombëtar droge dhe që është transformuar në biznesmen të suksesshëm me paratë e buxhetit të shtetit. Kjo është qeverisja që duam? Kështu do hyjmë në Europë?

Kreu i PD-së ka vënë kushte se pa bërë vetingun e politikës, nuk do të ketë asnjë pakt me Edi Ramën. Përdërisa opozita nuk i ka votat në Kuvend, pse refuzon dialogun me mazhorancën?

Ndryshimet kushtetuese për vetingun e politikanëve, të propozuara nga opozita janë ose merr, ose leri. Janë identike si ndryshimet kushtetuese të miratuara për vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ne nuk kishim vota as për ligjin e dekriminalizimit, por ia arritëm ta miratojmë.

A do pranoni që kërkesa të dërgohet në Komisionin e Venecias?

Është një manovër e mazhorancës për ta shtyrë vetingun e politikanëve në kalendat greke.

Kreu i PD-së, Luzlim Basha, para pak ditësh kërkoi mbështetje nga Gjermania për vetingun e politikanëve. Si është menduar ndërhyrja ndërkombëtare

ZGJEDHJET

"Edi Rama është armik i zgjedhjeve të lira e të ndershme. Ai i fiton zgjedhjet me paratë e krimit dhe përdorimin e kontingjenteve kriminale, administratës publike, policisë dhe çdo mjet tjetër të cilin e disponon për shkak të pushtetit absolut që ka mbledhur", tha z. Spaho.

hen në këtë mega-afërë korruptive. Qytetarët janë mjaft të qartë. Për fat të keq ka mjaft media dhe një takëm të ashtuquajtur "intelektuale", që nuk ngrenë zërin, por struken nga frika ose ndonjë kockë që iu hedh pushteti. Lexova një shkrim të Claudio Rocca, drejtor i "Accademia di Belle Arti" të Firences dhe autor i 12 librave për arkitekturën. Ai fliste me shqetësim dhe revoltë për prishjen e Teatrit Kombëtar të Tiranës. Zotëria nuk ka asnjë lidhje me Shqipërinë, por si intelektual dhe profesionist ngrinte zërin kundër prishjes së identitetit dhe arkitekturës meshdhetare dhe zëvendësimit të tyre me objekte moderne pa identitet. Argumentet e tij rrezonin tërësisht propagandën kryeministore dhe sejmënëve të tij se do i japin Ti-

në këtë proces?


Ndërkombëtarët dhanë ndihmë të çmueshme për miratimin e ligjit të dekriminalizimit, i cili me të mirat dhe titet me rekorde kriminale nga politika dhe administrata publike. E njëjta ndihmë mund të jepet edhe për vetingun e politikanëve. Por, refuzimi i Edi Ramës për vetingun me ligj të politikanëve provoi se Rama është peng i krimit. Kryeministri i krimit po përdor drejtësinë e tij dhe mediën e tij për të mashtuar shqiptarët. Rama e refuzon vetingun me ligj të politikanëve, sepse vetë ka lidhje me kokat kryesore të krimit të organizuar.

Nëse bëhet vetingu i politikanëve, çfarë ndodh më pas...?

Miratimi i ligjit të vetingut të politikanëve rrezon gjysmën e qeverisë dhe një pjesë të mirë të grupit parlamentar, si të lidhur me krimin e organizuar.

Lidhur me miratimin e ligjit për Teatrin e ri Kombëtar, sipas jush, ku u shkëlqoi? Kushtetuta thotë se presidenti nuk mund të ketë dy herë të njëjtin ligj, por sipas jush, cila është "hileja" e qeverisë për t'i hequr mundësinë z. Meta që ta rrezojë sërish ligjin e ri për Teatrin Kombëtar?

Opozita, presidenti dhe BE nga këndvështrimi dhe përgjegjësitë e secilit kanë folur mjaft qartë për muaj me radhe se ku shkelet Kushtetuta dhe cilat ligje anashkalo-



vetes dhe jo presidentit që qytetar i përgjegjshëm. Nuk është çështje juridike, por çështje e identitetit tonë, i cili po nëpërkëmbet nga një takëm të pangopurish, të cilët për para nuk njohin asnjë skrupull. Problemi duhet parë edhe më gjerë, Teatri është vetëm një nga pasojat e veprimtarisë së kësaj qeverie të kriminalizuar dhe të korruptuar. Për çdonjërin sot është e qartë, që shkaku i krizës që ka zënë vendin është qeverisja dhe Edi Rama. Që të shpëtohet vendi dhe të kemi të ardhme, duhet t'i largojmë ata. Kjo arrihet kur reagojmë të gjithë dhe t'i kundërvihemi të gjithë Edi Ramës dhe rrethit të tij.

Të ndalemi tek opozita e bashkuar. Kallimi i Shpëtim Idrizit në opozitë ngriti shumë pikëpyetje nëse Vangjel Dule do të qëndronte akoma, apo jo në frontin opozitar për shkak të përplasjeve të tyre. Por realisht a ka një çarje brenda koalicionit të opozitës?

Nuk ka asnjë çarje dhe për këtë çështje ka folur vetë z. Dule, i cili është pjesë e aleancës opozitare. Ne nuk jemi koalicion qeverisës. Ne jemi front opozitar për të larguar Edi Ramën nga pushteti si e keqja më e madhe që ka mbërthyer këtë vend.

A e dëmton aleancën opozitare afrimi i partive klienteliste? Cila tjetër përveç PDIU-së do t'i bashkohet PD-së në betejën kundër Edi Ramës?

Pavarësisht gjendjes shumë të rëndë që po kalon vendi, e pakrahastuar kjo me ndonjë periudhë të mëparmshme, asnjë herë nuk do të bëjmë thirrje që të bashkohen gjithë qelbërisht me ne për të ardhur në pushtet. Krimi i organizuar ka si shtëpi "Rilindjen" dhe atje do të mbetet. Ne mirëpresim çdo forcë politike, e cila kupton që sot nuk duhet rëndur pas përfitimeve partiake, por të shpëtojë vendin nga qorrsockaku ku na ka futur "Rilindja".

VETINGU

"Miratimi i ligjit të vetingut të politikanëve rrezon gjysmën e qeverisë dhe një pjesë të mirë të grupit parlamentar, si të lidhur me krimin e organizuar", tha z. Spaho.

ranës një teatër të madh, modern e futurist. Nëse doni të ndërtoni një të ri, shkoni dhe ndërtojeni diku tjetër, por mos prishni një godinë 80-vjeçare të një arkitekti të njohur italian dhe ta zëvendësoni atë me një godinë e cila nuk ka identitet, pavarësisht ku është, në Tiranë, Pekin apo në ndonjë qytet amerikan. Kjo ishte thirrja e zotit Rocca në respekt të historisë dhe kulturës shqiptare. Po kujt t'i thuash... "Këtu lulet nuk i hanë as gomerët", sikurse thuhet në "Koncert në Vitin 1936".

Si mund ta ndalë presidenti "palligjshmërinë" e asaj çfarë do të ndodhë me Teatrin e ri Kombëtar?

Këtë pyetje duhet t'i bëjë



Nga 1 janari, rritje pagash e politika të reja për të porsalindurit

Qeveria "hap thesin", Rama: Bonus 400 mijë lekë për çdo bebe të lindur

Azilantët, kryeministri: Nuk jemi më bunkeri i Enver Hoxhës

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama njoftoi dje se çdo çift i ri do të marrë 400 mijë lekë të reja bonus për beben e parë të lindur, duke filluar nga janari i vitit që vjen. Për beben e dytë do të jepet 800 mijë lekë, ndërsa për beben e tretë të çdo familjeje do të jepet 1.2 milionë lekë të reja. Përmes një lidhjeje nga Kryeministria me rrjetet sociale, së bashku me ministrin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Ogerta Manastirliu, Rama u shpreh: "Do të kemi rritje pagash në arsim, rritje pagash në shëndetësi, rritje pagash në ushtri, pas shumë e shumë vitesh pa asnjë rritje pagash në ushtri. Do të kemi lehtësime të rëndësishme taksash, kryesore, lehtësime të taksave për një pjesë të konsiderueshme dhe shumë aktive të biznesit që do të hyjë në kategorinë e biznesit të vogël e nuk do të konsiderohet më biznes i madh deri në 140 mijë dollarë xhiro në vit. Në vitet 2000, unë pata lanqar si kryetar i Bashkisë së Tiranës 'Çekun e Bebes', 50 mijë lekë të vjetra, i cili u prit shumë mirë asokohe. Por mbeti aq sa ishte për shumë e shumë vite dhe jo vetëm kaq, por u kthye në një problem. Mjafton të them që në malin e borxheve, të trashëguara nga qeveria e përparshme, ne kishim edhe një borxh prej 5 milionë dollarësh për bebet që nuk kishim marrë cekun që u takonte. Borxh që e shlyem, siç shlyem mbi 700 milionë dollarë borxhe, pa të cilat mund të kishim bërë prej kohësh punë që kemi nisur t'i bëjmë më vonë dhe si përfundim, asgjë më nuk ka ndryshuar në këtë politikë, e cila sot rikthehet në rendin e ditës, me një shumëfishim për fëmijët e porsalindur që nga 1 janari i vitit të ardhshëm", u shpreh Rama. "Që nga 1 janari i vitit të ardhshëm, çdo fëmijë i



Kryeministri Edi Rama

ovacionit, çdo bebe që lind në maternitetet e Republikës së Shqipërisë do të regjistrohet aty e nuk do të jetë më e nevojshme për të bërë gjithë atë procedurë të komplikuar me gjendjen civile e të tjera. Do të regjistrohet aty e do të marrë menjëherë cekun për mirëseardhjen në jetë në bashkësinë tonë, si një ndihmë e drejtpërdrejtë për familjet", saktësoi kryeministri. Ai njoftoi se qeveria po diskuton meqenëse se si do të ndërtohet mekanizmi i dhënies së këtij bonusi të ri të bebes. Sipas kreut të qeverisë, kjo është një praktikë e mirë e shumë vendeve, që nga Suedia deri në Greqinë fqinje. Nga ana tjetër, në përgjigje të komenteve e kritikave të qytetarëve, Rama siguroi se Shqipëria nuk është e mbytur në kredi. Më tej, Rama sqaroi se fëmija i tretë, i katërt, i pestë dhe më radhë janë të gjithë subjekt i bonusit 1.2 milionë lekë. Një nga komentet që i janë bërë në rrjetet sociale ishte edhe largimi i shqiptarëve si azilantë. Për këtë, Rama u shpreh: "Nuk jemi më bunkeri i Enver Hoxhës. Jemi një vend i lirë, fatmirësisht dhe njerëzit kanë lirinë e lëvizjes. Nëse shqiptarët kërkojnë azil politik, kjo ndodh vetëm për një arsye, sepse ende nuk jemi anëtarë të Bashkimit Europian dhe nuk kemi akses në tregun e lirë të punës".

Kreu i PS-së merr në mbrojtje deputeten Ferhati

Rama: S'jemi me oligarkët, kërcënimet e Lulzim Bashës janë për ndjekje penale

Kryetari i PS-së, Edi Rama, njëherësh kryeministër i vendit mori në mbrojtje dje deputeten socialiste Klodeta Bushka Ferhati, e cila u sulmua dje nga PD-ja. Gjatë aktivitetit për anëtarësimet e reja në Amfiteatrin e Liqenit Artificial, Rama e quajti një politikë që socialistët duhet ta përcmojnë. "Një dozë neverie, dekurajim negativiteti që nuk sjell asgjë të mirë", u shpreh Rama. Më tej, kreu i qeverisë tha se Lulzim Basha është i pabesueshëm në fushatën që ka nisur kundër sipërmarrësve më të mëdhenj në vend, pasi shumë prej emrave që u përmendën në listën 'Antimafia' janë klientë të kumatit të tij. "Ne duhet të ikim nga kjo fushatë balte. I merrni njerëzit për idiotë, ndërkohë që kjo duket ashikare për t'u thënë atyre, që ju që merrni në punë këtë qeveri, keni harruar të paguani. Kjo prek fushën e penales". Akuzave se Partia Socialiste është parti e oligarkëve, Rama iu përgjigj me shifra. Rama kritikoi edhe mediat që sipas tij më shumë sesa e vërteta, u intereson audienca. "Të fokusohemi tek problemet që duhen zgjidhur, shpifje, abuzime ku është e përfshirë edhe media në një aktivitet që nuk synon më mbrojtjen e një argumenti, thjesht synon publikun, synon audiençën me çdo kusht". Gjatë takimit, ai shkëmbu edhe butata me Pandeli Majkon. Ndërsa Rama e ftoi të jepte tesaerën e parë, Majko ia ktheu: "Nuk jam edhe aq i mbarë, se atyre që ua kam dhënë unë tesaerën janë zënë me këtë (për Ramën) dhe janë larguar nga partia".



JORIDA TABAKU

"Ne kemi pasur probleme me drogën vitet e fundit, nuk u pranua dhe u bë më fenomen fatkeqësisht për të keq në raportet ndërkombëtare. Më mirë ta pranojmë dhe të marrim masa se si ta zgjidhim, se sa ta mohojmë dhe ndoshta pas 5 ose 10 viteve të na dalë një kriter i ri në procesin e integritimit europian", tha Tabaku.

VENDIMET

BONUSI PËR BEBET

- 400 mijë lekë për fëmijën e parë.
- 800 mijë lekë për fëmijën e dytë.
- 1.2 milionë lekë për fëmijën e tretë.

■ Fëmija e katërt dhe e pestë do të marrin po ashtu 1.2 milionë.

- Kur janë binjakë do të marrin të dy sikur janë i dyti, pra, jo 400 + 800, por 800 + 800.
- Kur janë trinjakë, të marrin sikur janë të tretët, pra 3 x 1.2 milionë lekë.

RRITJE PAGASH:

- Në arsim
- Në shëndetësi
- Në ushtri

parë i një çifti do të marrë 8-fishin e bonusit, 400 mijë lekë. Fëmija i dytë do të marrë 16-fish të bonusit, 800 mijë lekë dhe fëmija i tretë do të marrë 24-fish të bonusit, 1 milion e 200 mijë lekë. Këto

do të shkojnë për të gjithë fëmijët e porsalindur në Republikën e Shqipërisë dhe jo vetëm kaq. Ndërkohë, Ministria e Shëndetësisë po përgatitet për një ndryshim të rëndësishëm, që përmes in-

Zgjedhjet në PD, gati emrat e grupeve të punës

Demokratët nisin përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme lokale. Kreu i PD, Lulzim Basha takoi pasditën e djeshme deputetët dhe drejtuesit e strukturave kryesore të partisë, ku në fokus ishin zgjedhjet e brendshme në parti. Basha pritet të nxjerrë një udhëzim të ri për zgjedhjet në degë, seksione dhe grup-seksione. Zgjedhjet në Partinë Demokratike pritet të nisin në fillim të muajit tetor dhe do të përkohjnë me eventidimim e kandidatëve që do të garojnë në zgjedhjet vendore të PD. Emrat që do kryesojë grupet e partisë në rrethet janë Edi Paloka, që kryeson grupin e punës në Kukës; Flamur Noka, drejtues i grupit të punës në Shkodër; Arben Ibro, grupin e punës në Lezhë, Fatbardh Kadilli, grupin e punës në Vlorë; Edmond Spaho, grupin e punës në Elbasan; Oerd Bylykbashi, grupin e punës në Durrës.



Ne kuader të zbatimit të projektit të dixhitalizimit të shërbimit material kombëtar për venien në funksionim të databazës shtetërore NISA, Dhoma Kombëtare e Noterisë (DH.K.N.) Ikon Operatore Ekonomike të huaj ose vendas për të marrë pjesë në këtë procedurë.

Dokumentat e projektit mund të terhiqen perkundrejt pagesës prej **10.000 leke**, prane Dh.K.N. në adresën Rruga Vaso Pasha, Tiranë, Shqipëri.

Propozimet do të pranohen brenda datës **7 tetor 2018 ora 10:00 AM**

EPSA SHOQERIA PËRMBARIMORE PRIVATE "E.P.S.A" SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR:

1- "Pyl" + Kullotë" me sip. 280.000 m2. Nr. hipotekor 168 datë 29.05.2012. ZK 3028. e ndodhur në Poro, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raiffeisen sh.a. Cmimi me të cilin fillon ankandi është 3.024.202 Euro. Ankand i zhvillohet datë 22.10.2018 ora 14.00 në adresën Rr. "Çemali", Pall. "Fratar", K.6.Tiranë.

2- "Pyl" + Kullotë" me sip. 45.000 m2. Nr. hipotekor 66 datë 25.03.2009. ZK 3028. e ndodhur në Poro, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raiffeisen sh.a. Cmimi me të cilin fillon ankandi është 1.020.000 Euro. Ankand i zhvillohet datë 22.10.2018 ora 14.00 në adresën Rr. "Çemali", Pall. "Fratar", K.6.Tiranë.

3- "Frash" + Ndërtim" me sip.3.250 m2 nga Kjo 14145 m2 ndërtues me adresë: Shkollë, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raiffeisen sh.a. Cmimi me të cilin fillon ankandi është: 490.699 Euro. Ankand i zhvillohet datë 17.10.2018 ora 16.00 në adresën Rr. "Çemali", Pall. "Fratar", K.6.Tiranë.

4-Për pasuritë me Nr.10071-15, vol.41, nr.89, ZK 8513, me sip.1192 me adresë Rr. "Mucot"15, Durrës. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Bankës Raiffeisen sh.a. Cmimi me të cilin fillon ankandi është 36.036 Euro. Ankand i zhvillohet datë 17.10.2018 ora 14.00 në adresën Rr. "Çemali", Pall. "Fratar", K.6.Tiranë

Për çdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epsa.al

SHOQERIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" Sh.p.k
Rr. "Fash Dalia", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë
Web: www.3h.al Email: info@3h-shqip.com cel:0692089711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.**25.09.2018 deri në dt. 05.10.2018** për: sendin e luajtshëm mjeti me targë AA 089 OB në pronësi të Subjektit Naber Konfeksion Shijak shpk me NIPT J62208504M
Cmimi fillestar është **1419 EURO**

Ankand i zhvillohet në zyrën përmbarimore në datën **05.10.2018** dhe mbyllet me orarin zyrtar **16.00**.



Laborator për drogë sintetike, arrestohen dy amerikanë në Tiranë

TIRANË - Dy shtetas amerikanë të kërkuar nga Shtete e Bashkuara të Amerikës për prodhim dhe shitje të drogave sintetike janë arrestuar ditën e djeshme në Tiranë. "Finalizohet operacioni antidrogë ndërkombëtar i koduar "Sintetiku" në bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese amerikane operacioni nga Policia Shtetë, Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe DEA Ameri-

kane. Arrestohen 2 shtetas amerikanë, të cilët strehoheshin në Shqipëri në zbatim të letër porosisë të autoriteteve amerikane, si dhe pas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për zbatimin e saj, Departamenti i Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit në bashkëpunim me Prokurorinë e Krimeve të Rënda dhe DEA-n amerikane pas një pune të

mirëorganizuar finalizuan me sukses operacionin e koduar "Sintetiku", ku u arrestuan 2 shtetas amerikanë: Vincent (Dominic) De Caro, 29 vjeç, lindur dhe banues në New York, USA; Arber Isaku, 29 vjeç, lindur dhe banues në New York, USA", thuhet në njoftimin e policisë. Ata kishin një bazë në Tiranë dhe sipas dyshimeve të para thuhet se do ta përdornin për

të prodhuar drogë sintetike. Ndaj tyre, Gjykata e Connecticut, SHBA kishte vendosur masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprën penale "Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope" kjo veprë e kryer nëpërmjet 'dark web'. Këta shtetas ishin nën hetim prej 1 viti nga DEA. Sipas policisë gjatë kontrollit në bazën ku fshiheshin dhe zhvillohin aktivitetin kriminal këta shtetas, u gjetën dhe u sekuestruan mjetet që do të shërbenin për përgatitjen e drogërave sintetike si edhe një numër i madh pajisjesh elektronike.

Sekuestrimit i 2.5 tonë hashash në 2017, Aurel Lazaj rrëfëhet te Krimet e Rënda

"Trafikoja drogë për llogari të grupit kriminal që drejtohej nga një ish-polic"

Dëshmitari i mbrojtur: Ngarkesat niseshin nga porti i Vlorës dhe Durrësit

Një bashkëpunëtor i drejtësisë ka pohuar ditën e djeshme në dëshminë e dhënë para Krimeve të Rënda se trafikonte drogë për llogari të një grupi kriminal, ku një prej organizatorëve ishte ish-oficeri i policisë Festim Lelaj. Aurel Lazaj, një ish-i dënuar për drogë, tashmë i penduar i drejtësisë, dëshmoi ndaj shtatë të pandehurve për trafikimin e 2.5 tonë hashash që u bllokuan në Ankona janarin e 2017.

Përpara trupës gjyqësore ai rrëfëu se për gjashtë vite me radhë, trafikoi hashash kundrejt pagesës. Dëshmitari i mbrojtur tha se ngarkesat niseshin nga dy portet kryesore, ai i Vlorës dhe Durrësit.

"Ngarkesa e fundit, ajo e janarit 2017, u nis nga porti i Durrësit dhe kishte destinacion Gjermaninë. Atje e priste i pandehuri Ermir Hoti. Por, kamioni me hashash, u bllokua në Itali dhe për mungesë të dokumentacionin nuk arritëm ta zhblokoni. Ndaj, me urdhër të organizatorëve, u vendos të dërgohej një kamion tjetër, që do të ndërrohej në Portin e Ankonas", tha dëshmitari. Sipas tij, Demo Progonati, i pandehuri që ndërroi jetë pak ditë më parë në një spital në Tiranë, udhëtoi drejt Italisë, me një tjetër kamion të ngarkuar me pelete. Atje i dorëzoi dokumentet Dhimo Korajit, i cili arriti të ndërronte targa e të merrte ngarkesën. Megjithatë, droga u bllokua nga policia italiane. "Te gjithë dyshuan se isha unë tradhtari. Me tu kthyer në Shqipëri u mora peng nga anëtarët e grupit, të cilët me mbajtën të lidhur në një fshat të Krujës", tha ish-trafikanti.

Gjithashtu, ai nxori në dritë fakte të reja, sipas të cilave me të njëjtin grup kriminal në 2011, ka trafikuar të tjera sasi droge nga Porti i Vlorës drejt Italisë. Pas dëshmisë së dhënë nga Lazaj, reagan avokate, të cilët kërkuan kohë për të drejtuar pyetje që do t'i drejtojnë dëshmitarit të mbrojtur. Për trafikimin e 2.5 tonë hashash drejt Ankonas, në Gjykatën e Krimeve të Rënda po zhvillohen dy procese paralele, ku mes të pandehurve, ka oficerë policie dhe doganierë.

ARRESTIMI

Më datë 13.01.2017 nga ana e Zyrës Ndërlidhëse të policisë italiane "INTER-



Dëshmitari i mbrojtur, Aurel Lazaj

FORZA" në Tiranë, është informuar Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, mbi sekuestrimit e një sasive prej 2 tonë e 530 kg

lëndë e dyshuar llojit "Cannabis Sativa" në portin e Ankonës në Itali, që ishte e ngarkuar në Kamionin "MAN", me drejtues shteta-

sin shqiptar Dhimo Koraj. Ky kamion më datë 09.01.2017 është nisur nga porti i Durrësit me destinacion Durrës-Bari. Policia italiane ka ar-

restuar në flagrancë shtetasin Dhimo Koraj, i cili shoqëronte kamionin në portin e Ankonës, ndërsa në listën e pasagjerëve figuronte si shofer i këtij kamioni Demo Progonati. Në kuadër të këtij procedimi janë arrestuar shtetasit e mëposhtëm: Skënder Siqeca; Arbi Mustafa; Agron Kapllani ish-punonjës policie; Gëzim Dervishi ish-specialist në trajtimin e qenve të shërbimit në Stacionin e Policisë Kufitare Durrës; Festim Lelaj, specialist për Hetimin e Krimeve në Komisaratin e Policisë Fier; Altin Katundi, me detyrë Doganier në Portin e Durrësit; Mikail Hila; Demo Progonati; Euron Hoti; Malton Lleshi; Aurel Lazaj.

SHKURT

Task Forca Antikorrupsion, Gjonaj: 9 të shkakruar, 21 masa

Grupet e kontrollit në Graportet përfundimtare të punës së Task Forcës Antikorrupsion kanë rekomanduar 21 masa disiplinore, prej të cilave 9 largime nga puna për 5 specialist në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër; 1 përgjegjës sektori dhe 1 specialist në ALUIZNI Shkodër. Këto janë rezultatet e Task Forcës Antikorrupsion të bëra të ditura nga ministria e Drejtësisë Etilda Gjonaj. "Nga inspektimet e kryera me grupe ndërinstancionale, janë evidencuar shkelje dhe abuzime, të cilat përmbajnë elementë të veprave penale të shpërdorimit të detyrës, për të cilët janë kryer kallëzimet penale në organin e Prokurorisë së Shkodrës", njoftoi ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj.

Lufta kundër krimit, Marku marrëveshje bashkëpunimi me homologun bulgar

Prokurorja e Përgjithshme Arta Marku ka firmosur sot Memorandumin e Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bullgarisë. Gjatë vizitës së saj në Bullgari, Marku u takua me ministren e Drejtësisë të Bullgarisë, Tsetska Tsacheva, Prokurorin e Përgjithshëm të Bullgarisë, Sotir Tsatsarov, përfaqësuesin e Këshillit Suprem Gjyqësor, Boyan Magdalincev dhe anëtarët e Kolegjit Prokurorial të Këshillit Suprem Gjyqësor dhe me Kryetarin e Memorandumit në fjalë i kushton një vëmendje të veçantë përpjekjeve për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut, forcimin dhe nxitjen e bashkëpunimit në luftën kundër krimit.

Audio-përgjimi për vëllain e Xhafajt, mbërrin në Ministrinë e Drejtësisë ekspertiza

TIRANË - Në Ministrinë e Drejtësisë në Tiranë ka mbërritur ditën e djeshme përgjigjja e laboratorit anglez për ekspertizën mbi audio-përgjimin e publikuar nga PD, ku kjo e fundit implikon vëllain e Fatmir Xhafajt, Agron Xhafaj, në pazare droge. Mësohet se detajet e ekspertizës angleze do të bëhen të ditura në vijim. Sipas procedurës, materiali po përkthehet dhe do t'i dorëzohet Prokurorisë për Krime të Rënda. Kujtojmë se pasi PD publikoi audio-përgjimin, dha dëshminë e dëshmitarit X Albert Veliu, që pranonte se kishte qenë pjesë e grupit të trafikuar të drogës me Agron Xhafajn dhe së fundi është ndihmuar nga ai për të siguruar një sasi kanabisi që do ta trafikonte. Në audio-përgjimin dëshmitari X ose Albert Veliu fliste me një person, të cilit i kërkonte ta ndihmonte me drogë dhe që supozohet prej tij se është Agron Xhafaj. Ky i fundit në përgjim e dërgonte tek një tjetër person për të marrë drogën, me justifikimin se po sulmohej vetë. PD në kohën kur publikoi audio-përgjimin, në maj të këtij viti, deklaroi se ky ishte një rast investigimi nga gazetari Jetmir Olldash. Në një deklaratë publike për mediat, Olldashi tha se kishte hetuar trafikun e drogës duke përdorur si bashkëpunëtor Albert Velium, i njohur ndryshe në Vlorë edhe me emrin Babale.

TIRANË - Pas zbulimit të disa bazave prostitucionit nga policia e Tiranës, të cilat funksiononin në disa qendra estetike, të tjera detaje dalin në dritë. Mësohet se përvëç shërbimeve estetike ushtrohej prostitucion në qendra masazhore "Lefteri Beauty Centre", "Tirana Masazh", "Pushi Masazh" dhe "SPA Megu". Qendra e masazheve "Lefteri Beauty center", ndodhet në rrugën e Dibrës. Kjo qendër administrohej nga një prej vajzave të arrestuara, 34-vjeçarja Lefteri Qerama. Nga kërkimet në rrjetet sociale rezultojnë dy adresa të hapura nga administratorja e kësaj qendre. Në postimet e saj shfaqen vajza të reja me veshje provokuese, ndërsa reklamohen masazhet relaksuese. Të gjithë klientët e interesuar për masazhe duhet të pagujnë deri në 50 mijë lekë të vjetra për 60 minuta.

Rrjeti i prostitucionit në Tiranë, ja si funksiononin qendrat e masazhit



Ajo që bie në sy është fakti se kjo qendër bënte shpesh njoftime për punësimin e vajzave të moshës 20 deri në 35 vjeç, me ose pa eksperience dhe në rrjetet sociale publikonte foto apo video të tyre, me mbishkrimin, staf i ri. Me diskrete ishte qendra e masazheve "Pushi masazh" në zonën e ish-

bllokut e administruar nga Anisa Mukaj, tashmë e arrestuar. Ajo ndodhej në katin e 5 të një pallati në rrugën Ismail Qemali dhe si njoftim kishte vetëm një tabelë në hyrje të pallatit ku shënohej edhe numri i telefonit. Bazuar në të dhënat e QKR ky biznes funksiononte që në shkurt të vitit 2016. Ndërsa qendra "Tirana Masazh" me administrator Henkel Daka, tashmë i arrestuar, nuk rezultoi i reklamuar në Facebook apo në rrugën Sami Frashëri ku është biznesi. Edhe në QKR ky biznes nuk rezultoi i regjistruar. E njëjta gjë ndodh edhe me qendrën e masazheve "SPA Megu" me administrator 43 vjeçarin me iniciale M.M, i cili është shpallur në kërkim.

Operacioni në 2017-ën, njëri u vra për pazaret e drogës. Ja si funksiononin grupet

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Gjykata e Apelit në Shkodër ka dënuar me 42 vite 5 muaj burg 10 persona të akuzuar si kultivues të bimëve narkotike kanabis sativa, ndërsa 8 të tjerë janë dënuar me 28 vite e 8 muaj burg, por janë lënë të lirë me kushtin që për 3 vite të mos kryejnë veprë penale. Ndërkaq, gjykata ka shpallur të pafajshëm një tjetër, ndërsa për një tjetër shtetas është pushuar çështja, pasi është ndarë nga jeta. Në këtë mënyrë, pas operacionit të policisë "Early Spring", që daton 8 shkurtin e vitit të kaluar, ku në total u arrestuan 27 persona të dyshuar si bashkëpunëtorë në kultivimin e bimëve narkotike në zonën e Dukagjinit, Gjykata e Apelit në Shkodër ka dhënë vendimin e formës së prerë për 19 persona, ndërsa për 7 të tjerë vijojnë ende gjyqet. Sipas vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë në Shkodër, në total janë sekuestruar 31.386 rrënjë kanabis të asgjësuar nga policia vendore në 166 parcela gjithësej, përmes 28 aksioneve të ndryshme gjatë periudhës 28 qershor-28 shtator 2016. Para arrestimit, për disa muaj me radhë këta persona të dënuar janë përgjuar nga prokuroria dhe policia dhe më pas është vepruar përmes kontrolleve në terren, duke gjetur edhe parcelat me drogë në Dukagjin.

DËNIMET E DHËNA NGA APELI

Gjin Lushi, me detyrë kryeplak i fshatit Khan, në njësinë Pult është dënuar me 5 vite burg; Dritan Lisaj, me detyrë kryeplak i fshatit Mguull në njësinë Pult është dënuar me 4 vite burg; Fatmir Ara me 4 vite burg; Gëzim Çakaj me 4 vite burg; Emiljan Qeftaj me 4 vite burg; Rinaldi Qeftaj me 4 vite burg; Pllumb Shpati me 4 vite burg; Luvigj Shpati me 4 vite burg; Benard Bungaja me 4 vite burg dhe Nikë Bashi me 4 vite burg. Ndërsa, shtetasit: Llesh Qeftaj, Nikë Qeftaj dhe Mark Bashi janë dënuar me 4 vite burg, por janë lënë të lirë me kusht që për 4 vitet e ardhshme të mos kryejnë veprë penale. Shtetasit e tjerë Gjon Ndrësaj, Mentor Bungaja, Gjovalin Gavrilaj, Ndoc Pashaj dhe Ndoc Bregu janë dënuar me 3.4 vite burg me kusht që 3 prej tyre për 4 vite të mos kryejnë veprë penale dhe dy të tjerë e kanë këtë kusht për dy vite. Apeli në Shkodër shpalli të pafajshëm shtetasin Dedë Koçeku, ndërsa është pushuar çështja për Angelin Shkambin, i cili u vra me 17 dhjetor të vitit të kaluar dhe një prej pistave të kësaj vrasjeje është edhe një borxh për shkak të pazareve të drogës. Përveç këtyre personave, për të cilët është

28 aksione antikanabis në Shkodër, Apeli jep 42 vite burg për 10 kultivues

Mes të dënuarve edhe 2 kryepleq, 8 të tjerë lirohen me kusht



Gjykata e Apelit në Shkodër

VENDIMI I GJYKATËS SË APELIT

- | | |
|-----------------------|---|
| 1. ANGJELIN SHKAMBI | - Pushohet çështja |
| 2. DEDË KOÇEKU | - I pafajshëm |
| 3. GJIN LUSHI | - 5 vite burgim |
| 4. DRITAN LISAJ | - 4 vite burgim |
| 5. FATMIR ARA | - 4 vite burgim |
| 6. GËZIM ÇAKAJ | - 4 vite burgim |
| 7. EMILJAN QEFTAJ | - 4 vite burgim |
| 8. RINALDI QEFTAJ | - 4 vite burgim |
| 9. PLLUMB SHPATI | - 5 vjet e 4 muaj |
| 10. LUVIGJ SHPATI | - 4 vite burgim |
| 11. BENARD BUNGAJA | - 4 vite burgim |
| 12. NIKË BASHI | - 4 vite burgim |
| 13. LLESH QEFTAJ | - 4 vite i dënuar me kusht që për 3 vite të mos kryejë veprë penale |
| 14. NIKË QEFTAJ | - 4 vite i dënuar me kusht që për 3 vite të mos kryejë veprë penale |
| 15. MARK BASHI | - 4 vite i dënuar me kusht që për 3 vite të mos kryejë veprë penale |
| 16. GJON NDRËSAJ | - dënohet me 3.4 vite me kusht që për 4 vite të mos kryejë veprë penale |
| 17. MENTOR BUNGAJA | dënohet me 3.4 vite me kusht që për 5 vite të mos kryejë veprë penale |
| 18. GJOVALIN GAVRILAJ | dënohet me 3.4 vite me kusht që për 5 vite të mos kryejë veprë penale |
| 19. NDOC PASHAJ | dënohet me 3.4 vite me kusht që për 4 vite të mos kryejë veprë penale |
| 20. NDOC BREGU | dënohet me 3.4 vite me kusht që për 4 vite të mos kryejë veprë penale |

VAZHDON GJYKIMI NE APEL PER SHTETASIT:

1. ARDIAN LOCI
2. NIKË LAMI
3. ALFRED RRIPAJ
4. PAL DUSHKU
5. PLLUMB DUSHKU
6. GJOKË GJERGJI
7. GJON KODRAJ

TË DËNUAR NË TOTAL, 10 PERSONA ME 42 VITE E 5 MUAJ BURG

8 persona të dënuar me 28 vite e 8 muaj, me kusht që të mos kryejnë veprë penale për 4-5 vite.

Për 7 persona vijon gjykimi në Apel.

Për 1 person pushohet çështja, 1 person i pafajshëm.

Në total, 31.386 rrënjë të asgjësuar në 166 parcela në 28 aksione policie në periudhën 28 qershor - 28 shtator 2016.

dhënë dënimi i formës së prerë, për 7 shtetas të tjerë do të nisnin seancat gjyqësore në Gjykatën e Apelit, pasi që në Shkallën e Parë për ta është veçuar çështja në gjykim. Bëhet fjalë për shtetasin Ardian Loci, me detyrë shofer tek FNSH-ja e Shkodrës dhe shtetasit Nikë Lami, Alfred Rripaj, Pal Dushku, Pllumb Dushku, Gjokë Gjergji dhe Gjon Kodraj.

SKEMA, SI FUNKSIONONIN GRUPE TË KULTIVUESVE

Në vendimin që ka dhënë Gjykata e Shkallës së Parë vërehet se mes këtyre 27 shtetasve të përfshirë, bashkëpunimi nuk është i përhershëm për një ose disa parcela të mbjellë me kanabis sativa, por një bashkëpunim sipas nevojave të ndërsjella të

të pandehurve, ku secili, ose një grup i vogël prej tyre, kishin parcelat e veta, por jepnin ndihmesën edhe për parcelën, ose parcelat e një të pandehuri tjetër, ose grupi tjetër. Pra, ishte krijuar një lloj ekonomie bujqësore që shfrytëzonte toka të siguruar në territore me pronësi shtetërore (mes pyjeve dhe livadheve) e bazuar në kultivimin e bimëve narkotike, ku

shprehet një lloj bashkëpunimi i veçantë mes kultivuesve për ndihmë të ndërsjellë, që konsistonte në sigurimin e fidanëve, vendosjen e një farë rregulli për shfrytëzimin e burimeve ujore (shumë e domosdoshme në kultivimin e bimëve narkotike), ruajtjen e parcelave nga dëmtimet, këmbimin e informacioneve mes tyre, sidomos të lëvizjeve të policisë në zonë. Madje, ata bashkëpunonin për të siguruar edhe informacion nga policia dhe shpërndarjen e këtij informacioni tek të gjithë kultivuesit. Vihet re kjo nga përgjimet, jo vetëm tek përmbajtja e tyre, ku duket qartë bashkëpunimi spontan dhe sipas nevojave të rastit, por edhe fakti që janë të gjithë të pandehurit që komunikojnë njëri me tjetrin, direkt ose indirekt. Këta të pandehur kanë bashkëpunuar mes tyre që në ndarjen e zonave, në gjetjen e farave, në kultivimin e bimëve dhe në ujitjen e tyre, në ndarjen e radhës për ujitje dhe të punëtorëve dhe ndarjen e mjeteve të ujitjes, burimeve, zorrëve, pompave të ujit dhe gjeneratorëve, etj., dhe po nga këta të pandehur është bërë edhe ruajtja e parcelave, si dhe komunikimet mes tyre në ruajtjen nga policia si të parcelave, ashtu edhe të bashkëpunëtorëve, në mënyrë që të mos i gjendeshin sende të kundraligshme në banesa dhe në vendet ku qëndronin dhe mosgjetjen e bashkëpunëtorëve dhe punëtorëve të paguar prej tyre. Kjo e bën, në të shumtën e rasteve, shumë të vështirë ose të pamundur identifikimin e përkatësisë së sipërfaqes së kultivuar, por del qartë dhe pa asnjë dyshim se të gjithë të pandehurit janë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale. Në përgjimet që kanë personat që u dënuar nga Gjykata e Apelit dhe të tjerët që janë në gjykim, në disa raste bashkëpunonin për të shitur kilogramet e kanabisit, pasi e prodhonin apo ndihmonin njëri-tjetrin në ruajtjen e parcelave. Gjatë bisedave këshillorin njëri-tjetrin që në disa raste të qëllonin me armë ndaj policisë, kur efektivët shkollonin për të asgjësuar parcelat apo kishin dyshime për dekonspirimin mes të njohurve të përbashkët, ose në disa raste jepnin siguri për mbrojtjen nga policia për parcelat e tyre.

SHKURT

'Bypass'-i i Fierit e Vlorës, revoltohen 600 punonjës:

Do futemi në grevë

FIER - Përfaqësues të 55 kompanive nënkontraktore të "Serenissima" dhe punonjësit e tyre, të cilët ishin kontraktuar për ndërtimin e "Bypass"-it të Fierit dhe Vlorës janë hedhur për të 9 herë në protestë, pasi shprehen se ende nuk janë paguar për punën e bërë. Në total janë 600 punonjës, të cilët kërkojnë pagesën për punën e bërë gjatë periudhës 2015-2016 dhe kërkojnë angazhim maksimal të të gjithë aktorëve për zgjidhjen e situatës. Përfaqësues të kompanive nënkontraktore kanë theksuar se nuk do të lejojnë rifillimin e punimeve në këtë veprë. Pasi kanë bllokuar për disa minuta aksin Mbrostar-Fier, protestuesit kanë theksuar se nëse nuk marrin përgjigje brenda një jave, do të futen në grevë urie përpara Ministrisë së Transportit.

I dënuar me 11 vite burg për grabitje, arrestohet i kërkuari

GJIROKASTËR - Një 50-vjeçar i shpallur në kërkim për grabitje me armë në vitin 1999, është arrestuar nga policia e Gjirokastrës. Bëhet fjalë për shtetasin Adriatik Kanushi, banues në fshatin Arshi Lengo, i cili rezultoi i dënuar me 11 vite burg. "Ndalimi i këtij shtetasi u bë pasi Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë me vendim nr.204, datë 13.07.2018 ka dënuar me 11 vitet burgim për veprën penale "Vjedhja me armë". Ky shtetas më datë 20.02.1999, nën kërcënimin e armës u ka vjedhur një sasi lekësh shtetasve L.B., F.B., dhe M.I. të tre banues në "Përmet", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

Table with 2 columns: ID and Score. Includes sub-sections for 'Program studimi: Mbrojtje Bimësh' and 'NR IDMATURANTI REZULTATI'.

Table with 2 columns: ID and Score. Includes sub-sections for 'Program studimi: Menaxhim Agrobiznesi' and 'IAL ID MATURANTI REZULTATI'.

Table with 2 columns: ID and Score. Includes sub-sections for 'Program studimi: Menaxhim Turizmi rural' and 'NR IDMATURANTI REZULTATI'.

Table with 2 columns: ID and Score. Includes sub-sections for 'Program studimi: Teknologji Agrosuqimorë' and 'NR IDMATURANTI REZULTATI'.

Table with 2 columns: ID and Score. Includes sub-sections for 'Program studimi: Vreshtari Enologji' and 'NR IDMATURANTI REZULTATI'.

Table with 2 columns: ID and Score. Includes sub-sections for 'Program studimi: Mbarëshkrimi Pyjesh' and 'NR IDMATURANTI REZULTATI'.

Table with 2 columns: ID and Score. Includes sub-sections for 'Program studimi: Prodhim Bimor' and 'NR IDMATURANTI REZULTATI'.

Table with 2 columns: ID and Score. Includes sub-sections for 'Program studimi: Menaxhim i Burimeve Natyrore' and 'NR IDMATURANTI REZULTATI'.

NOFTIM SHITJE ME ANKAND
ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'
PASURIA ME NR. 27/1, E LLOJIT 'ARË', VOLUMI 1, FAQEJE 169, ZONA KADASTRALE 3852, SIPERFAQIJE 4.453 m2, NË ADRESËN: XHAFZOTAJ, DURRES, NË PRONESI TË Z. NEXHIMI VORA,

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përmbartimore "Bes 2010"
SHPALLJE ANKANDI
Më datë 19 tetor 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek ky zyrë përmbartimore do zhvillohet seanca e fundit e mbledhjes së ofertave për ankandim e l-rë, për shitjen e apartamentit nr. 3/218+1-18, vol 35, fq 39, ZK.8350, sip. 103.90 m2 me çmim filluesit ar. 61.000 lek/m2.

Shoqëria përmbartimore JUSTITIA
shpall ankandin, faza DYTE, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me këto të dhëna: Trulli+ Ndërtesë me sip. totale prej 250 m2, nga ku trulli 250 m2, dhe ndërtesë 101 m2, nr. pasurisë 9/283, Vol. 18/ fq. 101, zona kadastrale 8532 me adresë L. "Sheq i Madh" Fier, e regjistruar në emër të Enver Demir Buzi. Çmimi me të cilin fillon shitja në ankand është 3.640.000 (tre milion e gjashtëqind e dyzetë mijë) lekë.

Investitorët e huaj në Maqedoni parashikojnë situatën post-referendum

"Po s'mbështetëm integrimin, do të kemi pasoja"

Peter: Humbim një miliard euro nga Bashkimi Evropian

Kryetari i Këshillit të investitorëve të huaj në Maqedoni, Shtefan Peter tha se Maqedonia do të mund të ballafaqohet me një sërë pasojash ekonomike dhe financiare nëse votuesit e saj nuk e japin mbështetjen për integrimin euroatlantik në referendumin e së dielës. Zoti Peter parashikon, në një rast të tillë, humbjen e një miliard eurosh nga Bashkimi Evropian për Maqedoninë, zhvlerësimin e valutës kombëtare dhe një lloj izolimi për vendin ballkanik. Komuniteti ndërkombëtar u ka bërë thirrje javët e fundit votuesve në Maqedoni që të dalin në numër sa më të madh në referendumin e 30 shtatorit. Këshilli i investitorëve të huaj parashikon një të ardhme të zymtë për Maqedoninë nëse votuesit e saj nuk dalin në referendum dhe nëse vendi nuk ka mbështetje të brendshme për synimet e integrimit në Bashkimin Evropian. Shtefan Peter, kryetari i këshillit që përbëhet nga investitorët të huaj dhe vepron në kuadër të Odës Ekonomike të Maqedonisë, thotë se nëse Maqedonia vendos për t'i thënë JO, Bashkimin Evropian, atëherë ai sheh humbjen e besimit, në veçanti të besimit tek e ardhmja dhe se vendi do të humbiste ndihma të konsiderueshme financiare dhe me këtë Maqedonia do të shënonte një regres zhvillimor. "Në aspektin financiar parashoh humbjen e një miliard eurove për ndihma në zhvillim. Nëse i thoni: JO, BE-së do të jetë e vështirë ta mbani stabil denarin maqedonas. Monedha e një popullate dy milionëshe nuk mund të mbijetojë lehtë në aspektin afatgjatë", - tha biznesmeni austriak Shtefan Peter, i cili është anëtar i bordit të Kompanisë EVN që furnizon amvisëritë e Maqedonisë me energji elektrike. Skenari i errët do të vazhonte me largimin e të rinjve të shkolluar për shkak të mungesës së besimit. "Do të ketë izolim", thotë zoti Peter, ndërsa parashikon një trysni ndaj sektorit bankar;



Kryetari i Këshillit të investitorëve të huaj në Maqedoni, Shtefan Peter

VOTIMI TE DIELEN

Referendumi për ndryshimin e emrit të Maqedonisë mbahet këtë të diel. Mbi nëntëqind mijë votues duhet të dalin në qendrat e votimit, që është pesëdhjetë përqindësi i votuesve të regjistruar dhe gjysma e tyre, ose pak mbi 450 mijë të votojnë pro. Në atë rast, Maqedonia do të bëhet shpejt anëtarja e tridhjetë e NATO-s dhe do t'i hapë bisedimet për anëtarësimin me BE-në në qershorin e 2019-ës./VOA

ZAEV I BINDUR

Kryeministri Zaeu shprehu bindjen se kauza, "pro" marrëveshjes do të triumfojë dhe u bëri thirrje qytetarëve të marrin pjesë masivisht në referendumin këshillimor, që kërkon pjesëmarrës mbi 50% që rezultati të konsiderohet i vlefshëm.

zvogëlimin e importeve dhe eksporteve për shkak të mungesës së marrëveshjeve për lehtësime doganore; kompanitë vendore, sipas tij do të mund të humbin konkurrencën; Do të ulen investimet direkte të huaja për shkak të mungesës së një perspektive afatgjatë dhe për shkak të uljes së

konkurrencës brenda vendeve të BE-së me paga më të ulëta, siç janë Bullgaria dhe Rumania, por dhe vendet kandidatë për anëtarësim apo që synojnë integrimin si Shqipëria dhe Kosova, thotë Shtefan Petr i këshillit të investitorëve të huaj në Maqedoni. "Maqedonia do të përjashtohet

nga e tregtia e lirë me 27 ose 28 shtetet tjera dhe me këtë do të uljet konkurrenca në tregjet e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa do të mungojnë nxitësit në më shumë fusha si sundimi i ligjit, ambientit jetësor, ndërkohë që do të ketë ballafaqime në aspektin e të drejtave të konsumatorëve, të

Intelektualët shqiptarë në Maqedoni: Votoni në referendum. Të njihet gjuha jonë

SHKUP-Këshilli i Intelektualëve Shqiptarë në Maqedoni, në një konferencë për mediat, u ka bërë thirrje shqiptarëve të Maqedonisë të votojnë në referendumin e 30 shtatorit, i cili do të hap rrugën për anëtarësim në NATO dhe Bashkimin Evropian (BE), raporton Anadolu Agency (AA). Përveç thirrjes, këshilli ka miratuar edhe një memorandum për rregullimin dhe garantimin me kushtetutë të statusit juridik-kushtetues dhe politik të popullit shqiptar në Maqedoni, përmes të cilit kërkon që populli dhe gjuha shqipe të përfshihen në kushtetutë si element shtetformues. Siç thuhet në memorandumin e miratuar të Këshillit të Intelektualëve Shqiptarë në Maqedoni, të cilin e prezantoi në një konferencë për mediat, pas një referendumi të suksesshëm pritet të fillojnë edhe ndryshimet kushtetuese, për cka intelektualët kërkojnë që në këto ndryshime të përfshihen edhe çështjet e hapura për të drejtat kolektive të shqiptarëve, të kontestuara që nga pavarësimi i Maqedonisë e deri më sot, me cka në kushtetutë do të bëhen ndryshimet e kërkuara. "Republika e Maqedonisë është shtet nacional i popullit maqedonas, shtet i popullit shqiptar, si dhe bashkësive etnike turke, rome, vllhe, bullgare, serbe, boshnjake dhe të tjerë që jetojnë në këtë shtet", tha Adil Mustafa, pjesë e këshillit. Ai kërko që edhe çështja e gjuhëve zyrtare në Republikën e Maqedonisë të rregullohet dhe garantohet me nenin 7, dhe atë siç vijon: "Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, gjuhë zyrtare të jenë gjuha maqedonase dhe shkrimi i saj cirilik dhe gjuha shqipe dhe shkrimi i saj", -tha më tej Mustafa. Ai sqaroi se memorandumit që në vete ngërthen një sërë çështjesh që lidhen me statusin e shqiptarëve në vend, do t'i dërgohet kryeministrit të vendit, Kuvendit të Maqedonisë dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare për të sensibilizuar këtë çështje.BW

internetit, në huat dhe kreditë bankare", shtoi Peter. Që këto pasoja të mos ndodhin, ai bëri thirrje për pjesëmarrje aktive në demokraci: "Jam plotësisht i bindur se dera për mënyrën e jetesës evropiane tani është e hapur për Maqedoninë. Ftesa nuk mund të jetë më e singërtë se çështje BE nuk është e plotë pa Maqedoninë", -thotë ai. VOA

HITLERI DHE LENINI, KANDIDATË PËR ZGJEDHJET NË PERU

Hitler Alba Sañchez quhet kandidati për kryetar të një qyteze të vogël në Perunë qendrore. Ai është 37 vjeç dhe të gjithë e njohin si "Hitleri i mirë". "Në të vërtetë Hitleri, Hitleri i mirë, kthehet në këto zgjedhje me mbështetjen e miqve, simpatizantëve dhe popullatës", tha ai gjatë një takimi me elektoratin. Ai ka drejtuar qytetën mes viteve 2011-2014. Por surpriza nuk mbaron me kaq. Në fletën e votimit të zgjedhjeve të 7 tetorit ai do të ketë përballë Leninin, Leninin peruan me identitetin e saktë Lenin Vladimir Rodriges Valverde.



FOTOLAJM

Shoqërohet gazetari Milaim Zeka, policia: Kërcënoi prokurorin

Policia kosovare shoqëroi mëngjesin e të mërkurës Milaim Zekën. Urdhri për shoqërimin në komisariat u lëshua nga Prokuroria Themelore e Prishtinës. Prokurorët konfirmuan ndalimin për mediat kosovare pas një deklarate kërcënuese të Zeka në një emision televiziv ndaj prokurorit special Afrim Shefkui, i cili ka drejtuar çështjen në të cilën deputeti akuzohet për mashtrim me vizat gjermane. "Ma përpara ia kisha falë nëse ma kish vra njërin prej fëmijëve në afekt sesa kështu me ia shkatërru njerëzve ëndrrat. Mua më kanë poshtëruar. Unë do ta ndjek këtë prokurorin me gjyq, me kanun e edhe privatisht. Nuk ia fali kurrë poshtërimin." Prokurori Shefkui nënshkroi urdhërarrestin e 16 tetorit të vitit të kaluar për Zekën. Ai u vu nën hetim pas dyshimeve se kishte mashtruar 920 kosovarë, se do t'i gisuronte viza punësimi në Gjermani... akuzat të cilat vetë Zeka i ka hedhur poshtë. Sipas mediave, Zeka do të qëndrojë në polici për 48 orë, deri në dhënie të masës së sigurisë.



DHEMBJET E SHPINËS NUK VIJNË VETËM NGA KURRIZI

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETIA SHQIPTARE

E enjte 27 Shtator 2018



Enca nxeh situatën dhe tund të pasmet



**"Pse u largove nga 'Klan'-i?"
Nevina tregon arsyen**

BULEVARDI POLITIK



«Spiropali publikon foton me vajzën e saj, entuziaste nga lajmi i Ramës për çekun e bebes

«Tenxherja, kundër bolierit...», ironia e ministrit belg me Shqipërinë

«Si Pacolli me Trumpin, edhe kryeministri irakian ka lënë nam duke iu vardisur Obamës

«Gratë e dy ministrave, bisedë me njëra-tjetrën



Aktorja, së shpejti me një monolog në skenë

EGLA CENO:

Po nuk u veshja si karakteri i pjesës sime, "ngrii" fare

"Miqtë e vërtetë nuk kanë nevojë "të bësh gjëra"

Aktorja, së shpejti me një monolog në skenë

Egla Ceno:

Po nuk u veshja si karakteri i pjesës sime, "ngrij" fare

"Miqtë e vërtetë nuk kanë nevojë 'të bësh gjëra'"

Egla Xhemali

Sezoni i ri artistik ka nisur dhe skena e teatrit pret pjesë me impakt impresionues për publikun. Aktorja Egla Ceno rreshtohet krahas personazheve të zgjedhura për faqet e "Gazeta Shqiptare". Interivistat mbeten vetëm copëza të shkëputura, që nuk na çojnë deri në thellësi të dikujt, asnjëherë nuk njafton një lexim që të njohim brendinë; 'lupa' jonë kërkoi përtej asaj që u tha me fjalë. E njohur për publikun në disa role, në teatër dhe kinema, Egla Ceno vjen për faqet tona me projektet e reja dhe diçka personale. Si një portë që hapet para nesh, e shfletuar si një libër, Egla kalon nga ndjesia për skenën, tek përjetimet personale që të jep vendi ku banon apo rrethi miqësor. Trokasim lehtë dhe nisim ta njohim nga pak...



Çfarë 'këpucësh' të duhen për të shkelur në skenat shqiptare?

Këpucët e personazhit. Po nuk u veshja si karakteri i pjesës sime, po nuk fola si ai... unë "ngrij" fare. Del në pah droja ime dhe mirupafshim. Në përditshmërinë time, jam si Gavrosh shumicën e kohës. Nuk kam blerë kurrë një palë këpucë me takë më të lartë se 5 cm dhe as kam ndër mend të filloj të ble. Bëjnë keq për shpinën.

Ajo që do i thoshe tani një spektatori që ka ngrënë kokoshka gjatë një pjese teatri?

Do i flisja me fjalët e një personazhi që po punoj: "Heu! Nte! Nte! Nte! Ah! Hëm! Ah!! Yytt! Ptu! Buah! Pufff! Eh! Ihhhh! Ptu! Ihhh! Ptu! Ptu! Ptu! Paau!", - ja kështu do i thosha.

Roli te telenovela italiane "100 Vitrinat", një grua që vret burrin, ndjesia jote e brendshme?

Kam bërë shumë audicione për një rol atje dhe çdo herë ishte "Le faremo sapere". Është shumë e rëndësishme në profesionin tonë që të mësohesh të bësh llogaritë me refuzimin. Në momentin që je "IN", bëj punën tënde dhe rezulto i besueshëm. Kaq është. Paguhesh për këtë.

Koha më e përshtatshme për ta jetuar bukur një qytet?

Për mua, në verë, kur ka më pak njerëz. Unë preferoj të jetoj

në fshat dhe ashtu kam jetuar gjithmonë, por në Shqipëri, të jetosh në fshat, kthehet në mundim të madh.

Çfarë bën për të mbajtur afër miqtë e tu?

Asgjë. Miqtë e vërtetë nuk kanë nevojë "të bësh gjëra" që të qëndrojnë afër. Janë aty, sepse ti u pëlqen ashtu si je dhe anasjelltas.

Cila është mënyra përmes së cilës një mashkull mundet të të lexojë drejt?

Nuk e dija që burrat dinë të lexojnë... bëj shaka. Po kaloj te pyetja tjetër.

Çfarë do të thotë "ta marrësh jetën siç të vjen"?

E ka thënë edhe Papa Françesko: "Nëse nuk mëson ta jetosh jetën ashtu si vjen, nuk mund ta jetosh kurrë". Nuk mund të shtosh dhe të heqësh as edhe një presje.

Partnere me Elvis Pupën në komedi, çfarë gruaje mund të bëheshe në rrethana të vështira?

Shumica e punëve të mia kanë



registër dramatik. Vlerë të shtuar te komedia gjë mundësinë për të rrëfyer diçka, edhe dramatike, pa hequr dorë nga ironia dhe pa gjykuar. Humori që bëj në televizion bazohet mbi paradoksin. "Kodi i të shprehurit" është shumë ndryshe nga një film apo pjesë teatrale. Nëse do bëja të njëjtën gjë edhe në film apo teatër, do rezultonte aspak e besueshme dhe mediokre.

"Rruga e Qumështit", një pjesë nga Armand Bora, roli më ri që do të vësh në skenë?

Po. Do jem vetëm në skenë për rreth 1 orë e 30 minuta. Më pëlqeu shumë pjesa dhe mezi po pres ta performoj para publikut.

Ka edhe ngjyra humori, edhe dramë të fortë. Rrëfen të vërteta të rëndësishme që kanë lidhje të drejtpërdrejta me historinë tonë. Po punoj për të.

"At Sergei" e Tolstoit, çfarë i sjell realitetit në Shqipëri kjo pjesë?

Novela e mrekullueshme e Tolstoit, metaforikisht, i fut dorën brenda njeriut dhe e kthen mbrapsht si një triko leshi. Unë jam shumë e kënaqur që jam pjesë e vënies në skenë të kësaj shfaqjeje, nga regjisori Fatos Berisha. Ka kast të dashur për mua dhe mendoj se i ka të gjithë përbërësit për të "gatuar" diçka super të shijshme.




Enca nxeh situatën dhe tund të pasmet

Ajo është një nga këngëtares më të dashura për publikun. Bëhet fjalë për Encën. Këngëtarja shihet në një mbremje duke tundur të pasmet. Enca ka kohë që po punon për të sjellë një këngë që pritet të shndërrohet në hit, por siç duket, ende nuk po ia arrin. Ajo ka postuar në rrjetet sociale një video ku shihet duke u argëtuar në një mbremje, ndërsa bën lëvizje provokuese, madje duke tundur të pasmet gjatë gjithë kohës. Këto ditë pritet të publikohet bashkëpunimi i saj me Don Phenom, për të cilin këngëtarja ka ndryshuar edhe stil.



"Pse u largove nga 'Klan'-i?" Nevina tregon arsyen

Këtë sezon televiziv moderatoren Nevina Shtylla e kemi parë si prezantuese në emisionin "Procesi Sportiv" në "Top Channel". Ditën e djeshme, ajo u është përgjigjur disa pyetje të ndjekësve në rrjetet sociale, ku një prej tyre e pyeste se përse u largua nga "Klan". "Kjo që jam sot vjen falë të tjerë faktorëve, me në krye familjen time. Kam punuar me shumë përkushtim për gjithçka dhe besoj se e kam merituar çdo 'feedback' pozitiv dhe mbështetjen tuaj. 'Klan'-it i jam mirënjohëse për një sezon fantastik, por në 'Top Channel' mendoj se do të arrij maksimumin tim, me një investim të vazhdueshëm dhe mbi të gjitha të mirë-menduar", - shkruan Nevina në profilin e saj në "Instagram".




Yllka Kuqi si asnjëherë më parë, këngëtarja ekspozon gjoksin

Këngëtarja vjen shumë "e nxehtë" dhe në superformë. Yllka Kuqi së fundi është shfaqur në një fustan të krijuar nga Valdrin Sahiti. Yllka dhe Valdrini kanë 'rrezikuar' në modelin e veçantë të fustanit, që i ekspozon gjoksin këngëtares. Fustani i gjatë e i zi i shfaq për mrekulli format e trupit këngëtares, derisa ajo ka bërë edhe një video ku tregohet fustani nga të gjitha këndet.



Greta Koçi me adhurues të fshehtë, merr dhuratën e ditëlindjes në mëngjes

Këngëtarja Greta Koçi feston sot ditëlindjen dhe ka marrë një dhuratë të veçantë në orët e para të mëngjesit. Një admirues i fshehtë ka vendosur që ta surprizojë këngëtares, duke i dërguar një tufë me trëndafila të kuq dhe çokollata. Kjo ka qenë një surprizë tejet e bukur për Gretën, e cila shprehet se nuk e di se kush ia ka dërguar këto dhurata. "Kush mi dërgoi?", pyet Greta në "Instastory", ku po pret që t'i shkruajë adhuruesi në fjalë. Le të kujtojmë që ajo tashmë i ka lënë pas të 16-tat dhe ka mbushur plot 27 vjeç.



KESHILLA

Para se të mendoni për problemet me kurrizin, sigurohuni në mos po ju dërgon sinjale ndonjë organ tjetër i trupit

Problemet me fshikëzën, veshkat ose tëmthin shpesh mund të jenë të "maskuara" me dhembjen e shpinës. Prandaj, para se të mendoni në problemet me kurrizin, sigurohuni në mos ndonjë organ tjetër i trupit dërgon sinjale, të cilat manifestohen me dhembje tërëse në fund apo në mes të shpinës.

TRAKTI URINAR

Infeksionin e rrugëve urinare më së shpeshti e shkaktojnë bakteret. Manifestohen si dhembje gjatë urinimit, dhembje në pjesën e poshtme të shpinës apo në bark. Më së shpeshti i sulmon femrat dhe nëse nuk shërohen, mund t'u shkaktojnë edhe inflamacione.

GUR I VESHKAVE

Dhembje e vazhdueshme në një pjesë të shpinës, e cila shfaqet me dhembje në stomak, me rastin e urinimit apo me gjak mund të jetë shenjë e gurëve në veshka. Rol të madh ka edhe gjenetika, prandaj disa njerëz janë më të prirë të kenë gurë në veshka se sa të tjerët.

INFLAMACIONI I VESHKAVE

Nëse bashkë me dhembjen në shpinë shfaqet edhe temperatura e lartë e trupit, gjendja e tillë mund të tregojë inflamacion të veshkave. Ajo dhembje më së shpeshti shfaqet në pjesën e poshtme të shpinës dhe mbi komblik. Gjashtë herë është më e shpeshtë te femrat se sa te meshkujt.

INFLAMACIONI I PANKREASIT

Inflamacioni i pankreasit, pos dhembjeve në pjesën e poshtme të stomakut, vijon me dhembje të shpinës. Ajo dhembje mund të jetë e befasishme dhe të përhapet nga barku në drejtim të shpinës, mirëpo më shpesh është pasojë e inflamacionit akut apo kronik.



Dhembjet e shpinës nuk vijnë vetëm nga kurrizi



Spiropali publikon foton me vajzën e saj, entuziaste nga lajmi i Ramës për çekun e bebes

Deputetja e PS Elisa Spiropali nuk e ka fshehur entuziazmin për vendimin e qeverisë, e cila nga 1 janari për çdo çift që sjell në jetë fëmijën e parë jep 400 mijë lekë të vjetra, për të dytin 800 mijë lekë dhe për të tretin 1 milion e 200 mijë lekë duke shumëfishuar kështu vlerën prej 50 mijë lekësh që jepej më parë. "Lajm i mirë për nënat dhe familjet e reja! Politika e re për fëmijët e porsalindur nga 1 janari, 40 mijë lekë të reja për fëmijën e parë; 80 mijë lekë për fëmijën e dytë; 120 mijë lekë për fëmijën e tretë. Reformat po japin rezultate dhe krijojnë mundësi të reja, si kjo më e fundit për rritjen me 8, 16 dhe 24-fish të çekut të bebes (5 mijë lekë prej afro 15 vjetësh, qëkur u fut për herë të parë nga Bashkia e Tiranës)" shkruan Spiropali dhe publikon pikërisht këtë foto të hershme që lidhet me momentin kur ajo u bë nënë për herë të parë.



Tenxherja, kundër bolierit...!, ironia e ministrit belg me Shqipërinë

Arrestimi i Safet Bajrit, një nga anëtarët e grupit kriminal që u godit së fundmi, ka shkaktuar një përplasje në distance mes autoriteteve shqiptare dhe atyre belge. Shkak, me sa duket është bërë një deklaratë e zv.ministrit të Brendshëm, Besford Lamallari, për mediet belge, i cili është shprehur se autoritetet e këtij vendi kanë vonuar me 5 muaj dërgimin e dosjes për këtë shtetas. Por, në një studio televizive, ministri belg i Drejtësisë, Kohen Geens, megjithëse pranoi se autoritetet e vendit të tij mund të kishin punuar më shpejt, përmendi edhe doza ironie për Shqipërinë. "Ky vend është në një betejë, në të cilën tenxherja vazhdimisht fajëson bolierin",- tha Kohen Geens. Për këtë shprehje, ministri belg i referohet betejës së ashpër në Shqipëri mes shumicës dhe opozitës rreth korrupsionit. Megjithatë, Geens ka vlerësuar bashkëpunimin e policive të të dyja vendeve.



BULEVARDI POLITIK

Në merrni seriozisht! 😊

Si Pacolli me Trumpin edhe kryeministri irakian ka lënë nam duke iu vardisur Obamës

Ditën e kaluar zv.kryeministri i Kosovës, Behgjet Pacolli u bë qesharak pasi tentoi të takonte Donald Trumpin. Ndërsa, Trump i rrethuar nga rojet po ecte në korridor, një gazetar shqiptar i tha Pacolli: shko jepja dorën Trumpit, dhe ky menjëherë reagoi duke habitur edhe truporjet e tij, shkruan albeu.com. E megjithatë mundi t'ia japë dy sekonda dorën Trumpit dhe u gëzua shumë pasi e shiti si një kënaqësi të madhe në publik, por publiku vetëm qeshi me të. Por një rast qesharak ka ndodhur në vitin 2015 në samitin e G7 ndërmjet Presidentit amerikan të asaj kohe, Barak Obama dhe kryeministrit të Irakut. Gazetarët dhe kameramanët e Samitit të G7-s fokusuan përpjekjet e kryeministrit të Irakut, për të tërhequr vëmendjen e Presidentit amerikan, Barack Obama.



Gratë e dy ministrave

Gratë e dy ministrave të rinj po pinin kafe te dhe po ankoheshin për problemet e tyre. Njëra prej tyre tha:

- Paratë që merr burri im nuk mjaftojnë asnjëherë, nuk di si do ia dal mbanë.
- E dyta i mban ison:
- Ideale do të ishte të gjeje një të dashur që të të jepte 2 milionë lekë në muaj.
- E para ia kthen:
- Po, posi, po ku ta gjej se...
- Epo e njëjta gjë është edhe po të kesh dy të dashur që të të japin nga 1 milion...
- E para thotë:
- Të them të vërtetën edhe 4 të dashur me nga 500 mije lek secili në muaj, nuk do të ishte keq.
- Në këtë bisedë ndërhyr një plak, që ishte ulur në një tavolinë pranë tyre: - Dëgjoni, kur të arrini në 20-30 mijë lekë për të dashur, unë këtu jam...




STUDIMI

Peshkopata Arbanense, Gjon Kastrioti dhe grindja për kufijtë me peshkopatën e Lezhës

Kur peshkopët ishin edhe ambasadorë të Skënderbeut

Nga Prof. Aleksandër Meksi

Ligjërata ime trajton një temë me interes për periudhën që paraprin luftën e Gjergj Kastriotit si dhe për shekujt që pasuan. Ajo lidhet me një fakt të njohur të këtyre shekujve e të shumë debatuar për studiuesit vendas e të huaj. Është fjala për grindjen ndërmjet peshkopatës Arbanense dhe asaj të Lezhës (*Alexiense-Lexiense*), për përkatësinë e një sërë kishash që pretendohen apo kontestohen nga të dy palët dhe për vetë historinë e kësaj peshkopate. Deri më sot dëshmia më e vjetër për këtë grindje ishte një letër e Gjon Kastriotit, Atit të Heroit tonë, dërguar Serenisimës, e cila dëshmohej në Aktet e datës 3 prill 1407, ku nga sa kuptohet Gjoni shkruan se këto 12 kisha janë në territoret e tij e i përkasin Peshkopatës Arbanense prej 800 vitesh. Ai kërkonte që të ndërhyhej për të shmangur grindjet dhe trazirat ndër popujt e atyre viseve nga kjo padrejtësi. Në Aktet, pas një shpjegimi të shkurtër, jepet teksti i Letrës që i dërgohet Atit të Shenjtë, Papës Gregori i VII, ku i kërkojnë që të ndërhyjë në favor të peshkopatës Arbanense, për të detyruar Peshkopin e Lezhës *Alexiense* të mos i mbajë të zaptuara ato 12 kisha të Arbanense, në letër *episcopatum Albanie*, e vjetër prej 800 vjetësh. Kjo letër njihet prej kohësh nga studiuesit dhe është botuar nga Jireček, Ljubić, si dhe nga At G. Valentini në A.A.V. e më pas trajtohet nga Sufflay edhe prej studiuesve të mëvonshëm.



shkikshërimitin e tyre.

Duke dashur të jemi më të saktë në shqyrtimin e Letrës në fjalë dhe përmbajtjen e saj, arritëm të sigurojmë faksimilen e saj nga Arkivi Sekret i Vatikanit, që mundëson një lexim të saktë të saj, të pajtorëve të kishave dhe vendndodhjen e tyre. Dallimi më i rëndësishëm, nga çka dihej deri më sot, është se nga Peshkopi i Lezhës në dëm të Arbanensis *diocesis* janë zaptuar 17 kisha në 16 fshatra, dhe se ato kisha dhe fshatrat ku ndodhen lexohen me saktësi. Pra, tashmë për problemin që zgjatet në shekuj me debate, mund të flitet mbi të dhëna konkrete e të plota.

Së pari, në Letrën e Atit të Shenjtë lexohet se Ai ka pasur një ankim (*petitio*), me sa kuptohet të hollësisht (në datë të panjohur për ne), nga titullari i selisë episcopale Arbanensis peshkopi Georgij. Nga Letra rezultojn se ankimi është hetuar sipas rregullave, çka solli për pasojë urdhrin a porosinë e Vatikanit.

Së dyti, në Letër kemi Listën e plotë dhe të saktë të kishave në fjalë dhe vendndodhjen e tyre: Sancte Venere in *Baldreni*, Sancti Nicolai in *Blenisti*, Sancti Salvatori in *Malemalit*, Sanctu Johanis in *Merchina*, Sancte Eufemia in *Calameto*, Sancte Venere in *Vello*, Sancti Salvatoris in *Vello*, Sancti

Georgij in *Fico*, Sancti Blasij in *Solomundo*, Sancti Demetriji in *Span*, Sancti Alexandri in *Bochiano*, Sancti Nicolai in *Soyme*, Sancte Barbare in *Pedana*, Sancte Venere in *Re*, Sancta Maria in *Soesa*, Sancti Michaelie in *Castinetto*, Sancti Helie in *Gumiala*. Le të shqyrtojmë ku ndodhen ato kisha të 16 fshatrave, për të cilat deri më sot ka pasur vetëm hamendësime të kërkuara për përfundime aprioristike. Shumica e këtyre kishave ndodhen dhe sot në fshatrat me të njëjtin emër që i gjejmë në Listën.

- Në *Balldrë(n)* kemi kishën e Shna Prendës.

- Në *Blinisht* nuk gjejmë një kishë të Shën Kollit, por vetëm aty pranë në Kakarriq. Por, në Kadastrën Veneciane të vitit 1416-17 gjejmë si *Fshati Kakarriq* ashtu edhe *Fshati i quajtur Shën Kollit i Kakarriqit apo Blinisht*.

- e treta në listë duhet të jetë Kisha e Shelbuemit në *Akrolis*, mali në lindje të Lezhës nga e cila ruhet më shumë emri se sa gjurmë të rrënojave.

- Në *Mërgjinë* kemi kishën e Shën Gjinit.

- Në *Kallmet* kemi edhe sot kishën e Shën Eufemisë (Mia).

- Në *Velë* ndodhen dhe Shna Prenda dhe Kisha e Shelbuemit.

- Në *Rasfik* ndodhet kisha e Shën Gjergjit.

- Në *Grykë Manati* rruhet kisha e Shna Vlashtë dhe emri Solomund.

- Vendndodhjen e fshatit *Span* nuk kemi mundur ta gjejmë. Në ato zona, në shpinë të Lezhës, kemi vetëm një kishë me pajtor Shën Dhimitrin në fshatin *Tresh-Dardhë*.

- Mbi fshatin *Spiten* ndodhet kisha e Shën Llezhdrit të Bokianit

- Në *Zejmën* ndodhet kisha e Shën Kollit.

- Në *Pllanë* (Pëdhanë) ndodhet Kisha e Shën Barullës.

- Në *Rej* ndodhet Kisha e Shna Prendës.

- Në *Zeze* (Reja e Zezë) nuk njihet Kisha e Shën Mërisë.


- Në *Kashnjët* ndodhet Kisha e Shën Mëhillit.

- Në *Gjunal* nuk kemi gjetur ende një kishë me pajtor Shën Ilinë, por aty pranë, në Jezull (Gazull), përmendet një kishë me këtë pajtor.

Pra, këto 17 kisha në 16 fshatra, janë të gjitha në lindje të qytetit të Lezhës dhe mbi Lumin e Matit, d.m.th. në veri të tij.

Së treti, duhet të kërkojmë arsyen pse ndërhyri, në këtë grindje në krahun e Peshkopatës Arbanense Gjon Kastrioti. Pra, mendojmë se këto fshatra ishin në zotërimet e Gjon Kastriotit, apo se atij ju kërkuva ndihmë si një sundimtar i fuqishëm, në territoret pranë dhe me interesa për rrugët, portet detare të atjeshme dhe nevojën për marrëdhënie të mira me *Kishën* dhe sundimtarët vendas, duke dalë në mbrojtje të interesave dhe të drejtave të tyre. Me sa duket, ato troje dikur të Principatës të Arbrit, ndërkohë s'undoheshin nga shumë feudale të vegjël. Ne mendojmë se, duhet të kenë qenë krerët e *episcopatus Arbanensis*, ata që i kanë kërkuar mbështetje Gjon Kastriotit, me sa duket jo shumë të bindur se mund të zgjidhnin vet këtë problem në favor të tyre, duke shprehur të marrëdhëniet e mira e mbi baza interesi reciprok, ndërmjet Kastriotit dhe Republikës, e cila zotëronte nga viti 1393 dhe Lezhën, ndërhyrja e mbështetja Gjonit do të ishte e dobishme për ta.

Ka dhe një shpjegim tjetër, të nisur nga shprehja e Gjon Kastriotit që janë në zotërimet tona e janë të peshkopatës arbanense prej 800 vjetësh, se ato janë pra në toka të Kastriotëve. Unë mendoj se kjo shprehje është thjesht justifikuese për ndërhyrjen, për arsye afirmimi në një krahinë pranë territoreve të Gjon Kastriotit dhe me lidhje të vjetra me to. Mund të na ndihmojë për këtë një shënim në fund të Regjistrimit osman të vitit 1431-2, ku në timarin e Andre Karlo-s thuhet: *Edhe nëntë copë fshatra, sipas tavullit të Skënderbeut, birit të Gjonit u morën nga vilajeti i Dhimitër Jonimës dhe timari u regjistrua në regjistrin e tokës së Gjonit. Në rast nevojë të shihet [në] atë regjistër*. Ky shënim është i vitit 1441. Nga ky shënim ne kuptojmë se këto toka nuk ishin më përpara të Gjon Kastriotit, por i përkisnin Jonimëve.



PESHKOPATA ARBANENSE

Peshkopata e Arbrit dhe organizimi politik i krahinës ku ajo shtrihet është një temë që ka hapur diskutime të shumta për genien, shtrirjen dhe vazhdimësinë e saj në kohë. Përmendjen e parë të një peshkopate të Arbrit e hasim në aktin e shugurimit të kishës së Shën Trifonit në Kotor, në vitin 1166, ku merr pjesë titullari i saj *episcopus Lazarus Albanensis* dhe *Lazarus episcopus Arbanensis*. Në ceremoni, krahas peshkopit Lazar, i cili shuguron altarin në të majtë të kryesorit, merr pjesë dhe *Andreas prior Arbanensis*, me të cilin në historiografinë shqiptare është krijuar një pëshqjellim, duke e quajtur si të parë të krahinës, ndërkohë që duhet të pranojmë, duke u korrigjuar, se prior është i pari i komunitetit fetar në një dioqezë dhe që renditet pas peshkopit. Në mesin e shekullit XII, trojet e banuara nga shqiptarët, në aspektin e organizimit kishtar, janë nën juridiksionin e disa qendrave kishtarë. Në Shqipërinë e Veriut, nga kryepeshkopata e Raguzës-Epidaurit varen peshkopatat e Tivarit (Auarorum), Ulqinit (Licinianensem), Shasit (Suacinensem), Shkodrës (Scodrinensem), Drishtit (Driuatinsensem) dhe Pultit (Polatensem); në Shqipërinë e Mesme kemi Metropolin e Durrësit (Dyrrahut) nga e cila varen peshkopatat e Lezhës (Elison), Stefanikës (Stefaniacon), Krujës (Kroon), dhe Kuvavise (Hunavian); në Shqipërinë Lindore dhe Jugore Kryepeshkopatën e Ohrit me peshkopatat e Gllavnicës, Deabolit, Kaninës dhe Dibërës, ndërsa në Shqipërinë e Jugut peshkopatat e Himarës, Butrintit (Buthrotit) dhe Drinopojës (Drinopoleos) nën vartësi të Metropolisë së Naupaktit. Prej tyre peshkopatat e Shqipërisë së Veriut i takojnë kishës katolike, duke u varur nga Vatikani, me të cilën janë të lidhur dhe katolikët apo latinët e Durrrahut me një ardiqakon në krye.

Një vit më vonë nga përmendja në shugurimin e altarit të kishës së Shën Trifonit në Kotor (1167), papa Aleksandri III i drejtohet peshkopit "Lazarum episcopum de Albania" duke e lavdëruar që dëshiron të mohojë ritin grek dhe *ke vullnet i shmagësh në shumë raste kur të paraqitet mundësia ritit grek*. Në të njëjtën ditë, papa në një letër tjetër me vlerë të dëshmisë zyrtare, i konfirmonte kryepeshkopatës së Raguzës shufrangën e saj, por ndër ta nuk ishte peshkopata e Arbrit, e cila →

Opinion *i* Ditës

Reforma fasadë e shkollës digjitale shqiptare

Nga Shezai Rroqaj

(vijon nga faqja 1)

... anglosaksone e më gjerë. Në mënyrë të përmbledhur idetë e tij në fushën e edukimit synonin që shkolla duhet të zbulojë aftësitë individuale të individit: të gjithë lindim me talente natyrale, por pak prej nesh i zbulojnë dhe janë në gjendje t'i zhvillojnë. Pra, qëllimi i shkollës duhet të jetë të zbuluarit e veçanësisë së çdo nxënësi, që është prirja, talentin i tij dhe të nxisë atë proces formimi kurrikular që i përshatet zhvillimit të prirjes individuale të nxënësit.

Robinson pohon, gjithashtu, se qasjet e deritanismbe në shkollë janë mbështetur mbi bindjen e të tjerëve dhe jo të individit, duke përcjellë të nxënësit kurrikula e vlerësime standarde, të cilat mbytin të krijuarit vetjak dhe sheshojnë prirjet e veçanta. Procesi i mësimdhënies duhet të jetë krijues dhe jo standard e rrafshues e aspak uniformë për tërësinë e klasës. Edukimi është një sistem organik dhe jo një sistem mekanik.

Dimensioni i këtij koncepti në fushën e edukimit është shumë i gjerë dhe ka shkakuar tronditje metodologjike dhe strukturorë në mënyrën sesi është ndërtuar sistemi i edukimit, sidomos në disa kahje si: mësimdhënie me fokus klasën apo individin; mësimdhënie e vlerësimit standard për të gjithë klasën apo në funksion të prirjes së nxënësit; mësimdhënie proaktive që nxit qëndrimin kritik vetjak apo mësimdhënie informuese, mekanike, e rrafshuar, që nxit të mësuarit pasiv, përmendësh etj.

Sic mund të merret me mend, kjo përmbyse mendësie është një sfidë shumë e vështirë të realizohet menjëherë në arsimin e sotëm po të kemi parasysh traditën, grupet e interesit që përfshihen dhe mendësia e tyre e ngulitur dhe sidomos kostot që kërkohen. Bill Gates dhe Stives Jobs do t'i sugjerojnë administratës amerikane të kohës se ndër shkaqet kryesore të krizës së përgjithshme ishte sidomos sistemi i edukimit, i cili duke qenë masiv, po rrafshonte vlerat dhe po bëhej pengesë për nxitjen e gjënive krijues dhe po frenonte zhvillimin.

Të vetëdijshëm për situatën në fushën e edukimit dhe për sfidat që kërkoheshin të adresoheshin, administrata amerikane kuptoi se duhej filluar sa më parë me ndryshime të thella në fushën e edukimit. Dhe hapi i parë për t'u hedhur ishte sesi teknologjia e informacionit dhe inovacioni do të futeshin me shpejtësi në shkolla, me qëllim që të zgjeroheshin dhe të përshatëshin njohuritë në kohë reale në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në këtë mënyrë mësimdhënia do të përditësohej, pasurohej dhe diversifikohet, duke u dhënë hapësirë të mjaftueshme kreativitetit dhe fleksibilitetit. Nga viti 2011 e këtej shkollat digjitale u fut në sistemin arsimor. Tri-katër vite më vonë vendë si Gjermania, Franca, Italia, Holanda, Kanadaja e Japonia kanë përfshirë burimet digjitale në kurrikulat e tyre kombëtare.

I gjithë ky proces ka kaluar me



debate e diskutime të natyrshme, duke u vijuar në dy ryma mendimi në fushën e edukimit lidhur me përdorimin në shkollë të tekstit digjital (libër digjital, e-libër, libër elektronik) apo atë të shtypur (të printuar). Me tekst digjital është kuptuar përgjithësisht ose libri fizik i digjitalizuar me burime shtesë, kryesisht imazhe, audio, filma, video e të ndryshme, kuice, eksperimente, ose tërësia burimeve të mësipërme por, hera-herës, edhe thjesht një version i shtypur në format elektronik. Secila rrymë jep avantazhet dhe dizavantazhet e tyre në fushën e edukimit (shih Whaller 1987 për librin e printuar dhe Nelson 1987 për tekstin elektronik). Në fakt, ideja që njëri variant të zëvendësojë tjetrin, sot po gjen gjithmonë e më pak mbështetës dhe se ideja e zëvendësimit (ose njëri ose tjetri) po ia lë vendin idesë së përplotësimit (komplementaritetit) të tekstit fizik (të printuar) me burime digjitale që pasurojnë, përmirësojnë dhe diversifikojnë fushat përkatëse.

Sidoqoftë, procesi i digjitalizimit në këto vende u shoqërua me një diskutim të gjerë publik (Francë Gjermani, Holandë, Itali etj.), me një informacion shumë të gjerë, me fondet përkatëse, me ngritjen e organizmave dhe database-ve kombëtare që ndjekin procesin apo japin informacionet e konsultimet e nevojshme si dhe me ngritjen e strukturave për trajnimet e nevojshme si dhe afatet përkatëse. Në Francë, bie fjala, u përcaktuan edhe lëndët që do të jepeshin me burime digjitale, si: frëngjishtja, matematika, shkenca, gjeografia dhe gjuhët e huaja. Madje u qartësua edhe vetë koncepti "digjital" me të cilin kuptohej që materialet digjitale të plotësojnë, pasurojnë dhe përditësojnë lëndën në fjalë në orën e mësimi dhe jashtë saj". Nxënësit do t'i kishin falas burimet digjitale si në shkollë dhe në shtëpi dhe afati i zbatimit u përcaktua deri në vitin 2019.

Në Shqipëri, në vitin 2015 u reklamua si reforma më e madhe që të ndodhte. Madje ministria Nikolla e quajti "shkolla inteligjente e së ardhmes". Por, ndryshe nga

shumë vende evropiane, ku koncepti digjital u kuptua si një tërësi burimesh përditësoese, pasuroese, të larmishme dhe të diversifikuara me të cilat nxënësi punon në shkollë dhe në shtëpi, të cilat nuk zëvendësonin tekstin fizik, në Shqipëri koncepti "digjital" u interpretua si zëvendësim i tekstit të zakonshëm fizik, duke shtuar disa materiale, gjë që gjeti fill pasqyrim në Katalogun e ministrisë, madje mësuësit mund të zgjidhnin ose tekstin klasik ose atë digjital. Qartësisht në konceptin e MAS tekstit digjital zëvendësonte kryesisht tekstin fizik (librin). Pra, teksti i printuar kaloi në ciklet elektronik dhe u kërkuan edhe burime të tjera elektronike shtesë.

Doemos kjo reformë do të mbetej qysh në krye skematike (sa për të thënë) për këtë sipërmarrje kaq të gjerë burimore po të kihen parasysh mundësitë tona të pakta për "botën digjitale". Për më tepër edhe vendi si Franca konceptin e digjitalizimit e përkthyen si burime shtesë në plotësim të tekstit të printuar. Nga ana tjetër, nuk u ngrit asnjë strukturë dhe database operative për mësuësit, prindërit e nxënësit. Vetë ndjekjen e procesit e mori administrata dhe jo grupet e interesit. Nuk u hartua një plan afatgjatë për shtrirjen e shkollës digjitale edhe në 1-9 apo përtej 60 shkollave të pilotuara. Për më tepër nuk pati një plan financiar të veçantë për buxhetet vjetore, por u mjaftua vetëm të projekti i një vendi të huaj. Kësi reformash zgjatim sa mbarojnë dhe mbarojnë ende pa filluar apo, si i thonë, zgjasin aq sa shterojnë ato parat e projektit" mbi të cilat sulen "ushujtëzat" e administratës.

Po çfarë ka ndodhur deri sot me "shkollën inteligjente të së ardhmes", një reformë e trumbetur më të madhe tre vjet më parë? Sot, pas tre vjetësh, është vështirë të gjejmë informacione sistematike mbi problematikën e ecurisë konkrete të këtij procesi në secilën prej rreth 60 shkollave të mesme të pilotuara. Vetë pilotimi ngalli asokohë shumë diskutime, sepse reforma nuk po merrte parasysh kushtet dhe kontekstin e vendit

tonë dhe ku administrata që po e ndërmerrte nuk po përfshinte sa dhe si duhet grupet e interesit në procese këshillimi, njohjeje të situatës konkrete, si kishte ndodhur gjëkë, sepse, siç dihet, proceset kanë rezultat atëherë kur mësuësit e kuptojnë politikën e re të administratës, pra kur ata e kuptojnë ndryshimin dhe administrata ua jep kohën e nevojshme, i trajnon me metodat digjitale, ndërton database këshillues dhe struktura me ekspertë të fushave si dhe garantohen mjetet dhe burimet e nevojshme për tabletët.

Qysh në krye u vunë re vështirësitë lidhur me infrastrukturën, llojet dhe cilësinë e burimeve, interneti i pafuqishëm, tabletët, projektorët e deri të ndërprerja e energjisë elektrike, të cilat po bëheshin rreziqe potenciale që paralajmëronin dështimin gradual të saj. Mungesa e internetit në shkollë, apo ndërprerja e herëpashërshme e tij, pa folur për mungesën në shkallë të gjerë të internetit në shtëpi, numri i madh i nxënësve apo edhe mungesa e projektorëve nuk ishin ogur i mirë për suksesin e saj.

Nuk u hap as edhe ndonjë diskutim lidhur me dallimin midis tekstit digjital nga atij klasik (fizik) dhe si ndikon teksti digjital në përvetësimin e shpejtë, në shkurtimin e kohës së të mësuarit, mbi variueshmërinë e imazheve, videove, filmave eksperimenteve, dokumentarëve, në rritjen e kreativitetit dhe pjesëmarrjes aktive të tyre etj. Nga ana tjetër, duheshin trajtuar me seriozitet shkencor problemet që krijohen me teknikat digjitale si ato të shpërndarimit të nxënësit, i cili prirjet vetiu shumë pas filmave, humbja e vëmendjes në aftësinë për të kuptuar apo dhe në probleme shëndetësore, që lidhen me shikimin e jo vetëm, të cilat janë bërë objekt studimesh e debatesh në vendet ku është zbatuar e deri të zhvendosja e vëmendjes prej mësuësit te tabletët etj.

Po, a janë bërë analiza lidhur

me rezultatet, me përparësitë dhe me problematikat që kanë dalë, duke i krahasuar, bie fjala, me shkollat ku nuk zbatohet 'reforma inteligjente'? Po përballimi i kostos në vijim të kësaj reforme, kur dihet se kostoja librave digjitale është e lartë? Po për shtrirjen pa dallim e diskriminim në tërë sistemin shkollor dhe në tërë shtrirjen gjeografike qytet/fshat, a është menduar?

Po t'i këqyrësh nga afër këto shkolla shumë prej pyetjeve të ngritura mbeten pa përgjigje. Ndaj një audit kompleks në rreth 60 shkollat e pilotuara lidhur me gjendjen e sotme të "shkollës digjitale", për ecurinë e procesit në këto tri vite dhe të cilësisë së rezultateve, të fondeve të shpenzuara dhe të rezultateve të arritura, është urgjente. Po kështu duhet të analizohet se sa i trajnuar është stafi dhe gjendja e internetit aktiv në shkolla dhe në familje, të tableteve dhe të cilësisë së informacionit të përfshirë në to.

Pasi të bëhet transparenca e nevojshme, ndërmarrja e një reforme me asistencë ndërkombëtare të drejtpërdrejtë në shkollë është rruga për një reformë dobiprurëse digjitale në arsim e cila, sot për sot, nuk duhet parë si zëvendësoese e tekstit fizik, por si tërësi burimesh e mjetesh digjitale alternative që e plotësojnë, e pasurojnë, e përditësojnë dhe e diversifikojnë lëndën në fjalë gjatë orës së mësimi. Nga ana tjetër, është e nevojshme ngritja e një strukture operative joburokratike si dhe sigurimi në vazhdim i informacionit të nevojshëm bashkë me trajnimin e mësuësve dhe fondet e nevojshme. Të realizohet pra, një reformë jo sa për të thënë e për fasadë, e për të marrë 'q'ato fonde', por të jetë një reformë e plotë që t'i shërbejë shkollës dhe shoqërisë sonë.

Reforma fasadë e shkollës digjitale është pasqyra tipike e asaj që po ndodh me reformat në Shqipëri, të cilat nisin sipas përfundimit dhe, ose nuk përfundojnë fare, ose përfundojnë me sajme përcudnese alla shqiptarçe. E sa për idetë reformatore të Ken Robinson në fushën e edukimit në shkollën shqiptare as që mund të flitet sot, sepse shkolla po shkon teposhtë me rritjen e klasave kolektive e braktisjet masive të rinisë prej dheut të vet, si tokë e 'zënë' prej grykësisë e babëzisë së sulltanateve.

'Shkolla inteligjente e së ardhmes' ka mbetur po aq façadë sa ishte megaideja e internetit të dedikuar që Qeveria mori për sipër për ta lidhur Shqipërinë në rrjetet e mëdha ndërkombëtare të tipesi j-store etj., por që sot e gjithë ditën studentët, studiuesit apo vetë nxënësit mbeten të përhumur në librat e pluhurosor e i kur vaktit të bibliotekave tona, që u ka mbetur ora dhe vetëm emri. Por deri atëherë idetë e Ken Robinson do të mbeten vetëm një dritë në fund të tunelit.

KUPA E SHQIPËRISË

Pas Partizanit të kualifikuar dje në ndeshjen me Tërbunin, dje janë mësuar edhe 7 skuadrat e tjera të Grupit A, që do të kalojnë në turin e dytë të Kupës së Shqipërisë. Në fakt, skuadrat e mëdha e kanë siguruar kualifikimin thuajse që në ndeshjet e para dhe sot kanë hedhur në fushë

KUPA E SHQIPËRISË

- Grupi A**
Besëlidhja-Skënderbeu
Egnatia-Luftëtari
Kastrioti-Partizani
Vllaznia-Kamza
- Grupi B**
Apolonia-Kukësi
Bylis-Laçi
Tirana-Flamurtari
Lushnja-Teuta

lojtarët e stolit, duke qenë se kanë synimet e tyre në kampionat. Skënderbeu e Luftëtari, apo dhe Kamza e Kastrioti nga skuadrat e Superiores janë kualifikuar. Por, bien në sy edhe Besëlidhja, Egnatia e Vllaznia që e morën seriozisht këtë tur dhe do të vijojnë më tej. Vlen të theksohet se ka pasur ndeshje të hapura dhe të luftuara në Shkodër, Krujë

Kualifikohen të mëdhatë, ja çiftet e turit tjetër

e Rrogozhinë, ku ekipet respektive janë ndeshur për më të mirën. Në Grupin B, skuadrat e Superiores e kishin mbyllur llogaritë në një farë mënyre që në ndeshjet e para, ndërsa përplasjet e skuadrave të Kategorisë së Parë ishin inter-

esante. Flamurtari fitoi sërish në shtesë me gol të Mustës. Kukësi dhe Teuta fituan me gola, ndërsa Bylisi, Apolonia dhe Lushnja nuk e kishin edhe aq të lehtë, por ia dolën. Ballshiotët përmbysën humbjen e ndeshjes së

parë në Berat. Tirana luajti dje dhe fitoi 4-0 ndaj Ilirisë, duke kaluar në turin tjetër, ku do të ndeshet pikërisht me Flamurtarin. Sipas skemës së këtij kompeticioni, ju sjellim përballjet për të dyja grupet, A dhe B, në turin e dytë. Ndeshjet e para do të zhvillohen më 23 janar 2019, ndërsa ato të kthimit më 6 shkurt 2019.

Në "Selman Stërmasi" të premtën zerohen diferencat, por tropojani është plot besim



Jeton Selimi

Gega: Fitojmë për tifozët, Partizani ka më shumë kualitet

Trajneri i kuq flet pa dorashka përpara Tiranës



Skender Gega luan derbin e tij të parë si trajner. Si lojtar ka luajtur shumë, ka humbur dhe ka fituar. Madje, ka shënuar edhe gol. Ndaj për një grup të ri lojtarësh që ende nuk e kanë provuar aromën e derbit, Gega është një ekspert i vërtetë dhe si i tillë kërkon t'u injektojë të tijve besim për ndeshjen e së premtes. "Normal që derbi ka specifikat e veta dhe ka elemente pozitive e nëse e kalojmë me sukses, patjetër që do të shihet në dy aspekte, si pikët ashtu dhe ndeshja direkte për të rritur besimin të lojtarët. Vëmë nga një moment i mirë që ka ardhur gradualisht dhe javën që kaloi besoj se kemi bërë diçka të mirë. Me ekipin po punojmë dhe është vetëm fillimi, prandaj nuk jemi aty ku duhet dhe kemi nevojë për rritje e prandaj do të bëjmë edhe më mirë", nis të tregojë Gega në konferencën për shtyp.

Ndryshimi mes trajnerit dhe futbollistit?
Janë emocione më të mëdha, pasi përgjegjësia është e madhe. Kur je futbollist, i shkarikon emocionet dhe je vetë përgjegjës e i bën vetë zgjedhjet. Kur je trajner ke 25 lojtarë, staf dhe duhet të përgatisësh detajet e varet a

e merr apo jo përgjigjen që do. Presioni është, por edhe emocionet e ndryshme, por duke parë në sy futbollistët ndahet e kaluara dhe emocionet dhe e presim ndeshjen me kënaqësi.
Gjithmonë luhet për tifozët

Tifozët janë lojtari i 12-të të ne dhe ishim me fat që në takimin me Flamurtarin ato ishin nxitës të mëdhenj, pasi na mbështetën dhe mendoj se ua kthyem me të njëjtën monedhë. Edhe në derbi edhe çdo ndeshje tjetër duhet të dimë mënyrën si lua-

jmë dhe të bëjmë më të mirën. Mos të zgjedhimin ndeshjen me emocione, por të bëjmë më të mirën si në sulm e mbrojtje.
Pritja e gjatë te Partizani për një titull
Në shtëpi ndihesh shumë mirë, pasi kam ardhur që 18 vjeç dhe kam nisur karrierën. E kam provuar pa kushte dhe kam gjetur ambientin e duhur dhe Partizani ka histori të madhe. Fitoret e derbit, të shumë derbeve pasi janë bërë shumë. Është një lloj ngarkese pasi duhet të mbahet e njëjta gjë, por unë këtu jam për çdo ndeshje jo vetëm për derbin. Ne duhet të përmbushim objektivat dhe unë kam ardhur me mision për të çuar Partizanin aty ku duhet.
Kalimi i momentit negativ i Tiranës?
Nuk më tremb rritja e Tiranës, pasi jemi më të ndërgjegjshëm për atë rritje. E njohim më mirë dhe pashë

në ndeshjen me Skënderbeun dhe Tiranën dhe është një ekip me dëshirë dhe që vrapon. E kam studiuar dhe këto ditë do të studiojmë detajet. Nuk na tremb, por e respektojmë aq sa duhet dhe duhet të jemi në vendin e duhur e kohën e duhur.
Derbi apo objektivat?
Me gjithë respektin për tifozët, por edhe për çdo dashamirës është një punë që gatuhet sot dhe frytet nuk merren menjëherë. Nëse fitohet derbi, është shumë mirë dhe ne këtë duam e unë nuk hyj te njerëzit që vechohen nga sportdashësit, por unë hyj te tifozët dhe dua të fitoj çdo ndeshje. Ndeshjen më të mirë, unë e kam bërë kundër vëllait tim dhe kam dashur të fitoj, por kështu është futbollit. Objektivi është një projekt që duhet realizuar dhe tifozët duhet të shohin diçka afatgjatë.
Sa kualitetet keni në skuadër?
Në javët e para nuk thuhet

që jemi për kampionë, por gjërat shihen javë pas jave. Shpresoj që në ndeshjen me Tiranën të shkojnë gjërat siç ne dëshirojmë dhe ideja për vendet e para përforcohet dhe shihet çdo ditë. Më intereson që kemi grup dhe që po sillt mirë brenda dhe jashtë fushe dhe është baza për një trajner që të punojë komod. Futbollistët po punojnë siç duhet edhe për jetën e tyre, por edhe për të ardhmen e klubit.
Po ndryshimi me derbin e dikurshëm?
Të gjithë kemi qenë bio nga akademitë e klubeve, ndërsa sot kemi mix me lojtarë nga jashtë, por edhe nga brenda që nuk kanë lidhje me historinë e klubit. Fakti që po stërviten me mirë, janë korrektë dhe japin maksimumin besoj se kanë përgjegjësi dhe e njohin pasi është lehtë të dish e studiosh se çfarë ka ndodhur me Partizanin. Lidhja lojtarë-trajner duhet të funksionojë si familje.

UEFA VENDOS SOT

Erdogan kërkon t'i "rërmejë" Europeanin Gjermanisë

Turqia pret një vlerësim të drejtë dhe objektivi nga ana e UEFA-s për përcaktimin e vendit organizator të Europianit të 2024-ës. Ka folur për këtë çështje edhe presidenti i vendit, Rexhep Taip Erdogan, një ditë para se të merrret vendimi zyrtar, ku kandidatë janë Turqia dhe Gjermania. "Mendoj se një vendi të çmendur për futboll si Turqia, që i plotëson të



gjitha kriteret për të organizimin e këtij eventi, duhet t'i jepet kjo mundësi.

Nuk duhet të ketë dyshime, nëse stadiume do të jenë plot me tifozë apo jo në "European", - ka theksuar presidenti turk, Erdogan. Në bazë të raporteve për kandidatë që ka marrë në konsideratë UEFA javën e kaluar, ajo gjermane duket favorite. Mes pikave të dobëta të Ankarasë, është situata në lidhje me të drejtat e njeriut.

Gardiani i premtën besnikëri Evertonit


Pikford u mbyll derën klubeve të mëdha europiane



Madridit, nëse këta të fundit nuk arrinin dot të shërbimet e Tibo Kurtua, por Pikford ven-

dosi të qëndrojë. Sot, portieri 24-vjeçar ka nënshkruar një kontratë të re me blutë e Liverpoolit, një kontratë që premtën besnikërinë ndaj klubit që e bëri të njohur: Pikford ka nënshkruar për plot 6 vite dhe skuadrat që i duan tani shërbimet e tij do të duhet të paguajnë shumë më shumë sesa gjatë merkatos së janarit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Ishite dekret i sulltanit.
8. Fillojnë nazet.
9. Eshhtë bosht.
10. Eshhtë studio e Barack Obama-s.
13. Fillojnë romanin.
14. Pak nepozitëm.
17. Mbahen për të ndaluar.
18. Janë njerëz me dy faqe.
21. U mbiquajt Princi i oratorëve.
22. Nofka e Eisenhoëer.
24. Janë ministri.
25. Pak normalitet.
26. Rodrigues, që u quajt mbretëresha e fado-s.
27. Kush është... nuk është i lirë.
29. Bën be pa u betuar një e tillë.
30. Kështu mbyllet dera.
33. Eshhtë për medaljen e parë
34. Janë nofka.

38. Satelit i Jupiterit.
39. Fillojnë matjet.
41. Në krye tëv idealisatëve.
42. Një Ibrahim violinist.
44. Ekstrete në sirtar.
45. Kështu shtë lojtari i under 21.
47. Eshhtë gjuajjia personale.
49. Mund të ushtrohet edhe psikologjik
50. Gëlonin nga gladiatorët.

VERTIKAL

1. Eli këngëtare.
2. Pak ekologjike.
3. Rastis në kufij.
4. Janë tempereturat më të ulëta.
5. Inicialet e Lendi.
6. Jetojnë në kryeqendrën piemonteze.
7. Campion regjisore.
8. Gabim rrjete në tenis.
11. Janë si cilësi.
12. Ishite gjuha e romakëve.
15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
17. I vihet kalit.
18. Rrapo i luftëtarëve.
19. Aktet pa kufij.
20. Mbyllet me dorezë.
21. Eshhtë periudha e ftohtë.
23. Në krye të komandës.
24. Një artist si Tristan Tzara.
28. Janë sportistët që bëjnë stil të lirë.
31. Hapin pa kufij.
32. Qethen me qen.
35. Një mendim.
36. Kusturica, regjisor.
37. Parajsja e humbur.
39. Një stacion i famshëm orbital.
40. Pak aromatike.
43. Pak interesante.
46. Lirë në qendër.
48. Nota e diapazonit.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Bunuel regjisor.
4. Të parat në sport.
6. Rodrigues që këndonte fado.
11. I famshmi Pacino.
12. Kujdeset në... ekstreme.
14. Eshhtë sklavëri.
16. Eshhtë shtypji po përditshëm.
18. Janë tek në banka.
20. Eshhtë ndeshje e... fundit.
21. Lumi i Bernës.
23. Janë me numër ato ushtarake.
24. Nesti pa pa çifte.
25. Si gjithë.
26. Sipërfaqe e shkurtër.
27. Ato të peshkut janë pa vlerë
28. Janë marifete... me grim.
31. Ethet e tij zunë kërkuesit.
32. Skuadra merengue.

VERTIKAL


33. Eshhtë trofet që fitohet.
34. Ndahen nga ortakët.
36. Një biçikletë dyshe.
39. Qetësonte detin.
42. Kanë dhoma që zihen.
44. Eshhtë ekulibri në palestër.
46. Në krye të jurisë.
47. Numri i kuartetit.
48. Gjysmë armate.
1. Gjysma e lapsit.
2. Përfundojnë pingul
3. Shkruhen për filma.
5. Duhet realizuar.
6. Gabim pa kufij.
7. Portokalli i Stanley Kubrick.
8. Në krye të artistëve.
9. Eshhtë edhe ai i rekordeve.
10. Fleming që krijoi James Bond.
13. Janë binarë.
15. Janë dhoma.
16. Eshhtë i zi... pikant.
17. Institucione Lokale Tiranë.
19. Pagëzoi Shën Palin.
20. Eshhtë besimi i besimtarëve.
22. Janë pamje nga puna.
26. Janë aksione për... gol.
27. Një fjalë për më vonë.
29. Maria Rilke, shkrimtar.
30. Fillojnë turnin.
32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazil.
34. Eshhtë copë... torte.
35. Mbyllin një tender.
34. Ndo në kufij.
38. Një pëlhurë.
40. Lidh dy brigjet.
41. Një pije piratësh.
43. Fillojnë lehtë.
45. Të fundit në sirtar.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A | R | K | A | A | S | T | R | O | A | M | A |
| D | I | A | N | A | H | A | N | T | I | K | |
| A | T | L | A | N | T | I | K | E | O | L | S |
| P | E | I | T | A | R | I | F | A | T | L | E |
| T | T | P | O | L | I | T | I | K | A | N | E |
| K | E | N | E | T | A | O | K | A | R | | |
| P | A | U | L | I | N | R | | | | | |
| A | K | E | O | T | A | A | D | D | I | M | |
| R | E | U | M | U | N | E | K | I | E | R | A |
| T | E | J | I | T | E | R | I | A | M | A | N |
| I | N | T | A | R | O | N | A | T | I | T | |
| P | A | B | M | E | I | E | R | G | O | | |
| R | K | U | P | A | E | M | I | R | A | T | E |
| O | H | A | R | A | D | A | R | O | M | A | T |
| S | T | A | D | I | S | T | E | T | A | P | E |
| D | I | K | A | S | T | E | R | E | P | E | L |
| K | E | N | T | N | G | O | P | J | E | U | V |
| K | A | T | I | A | S | I | E | E | S | | |
| A | R | N | I | O | L | A | I | R | | | |
| M | A | S | S | I | M | O | Z | A | N | O | R |
| A | M | A | N | A | N | N | A | N | O | R | E |
| T | T | E | R | R | E | N | I | E | I | N | E |

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | | | | | | | | 2 |
| | | 9 | | | | | | 7 |
| | | 7 | 1 | | | | | |
| | 7 | | | | | 6 | | 4 |
| | 1 | 6 | | 5 | 2 | | 7 | 8 |
| 8 | | | | | | | | 3 |
| 7 | | 1 | | | | | | |
| | | 5 | | | 3 | 1 | 6 | |
| 4 | | | 2 | | | | | 8 |

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | 1 | 9 | 7 | 8 | 4 | 2 | 3 | 5 |
| 2 | 3 | 7 | 5 | 6 | 9 | 8 | 1 | 4 |
| 8 | 4 | 5 | 1 | 2 | 3 | 6 | 7 | 9 |
| 3 | 5 | 4 | 2 | 9 | 8 | 7 | 6 | 1 |
| 7 | 2 | 6 | 3 | 1 | 5 | 9 | 4 | 8 |
| 9 | 8 | 1 | 6 | 4 | 7 | 3 | 5 | 2 |
| 4 | 6 | 2 | 8 | 3 | 1 | 5 | 9 | 7 |
| 1 | 7 | 3 | 9 | 5 | 2 | 4 | 8 | 6 |
| 5 | 9 | 8 | 4 | 7 | 6 | 1 | 2 | 3 |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- I dua njerëzit që veshin shpirtin e tyre në fytyrë - Jim Morrison
- Indiferentët janë bashkëfajtorë dhe bashkëpunëtorë për të gjitha të këqijat që i ndodhin popullit.
- Urretja është shumë nënvlerësuar në këtë botë - Jim Morrison
- Një lidhje e fshehtë është gjithmonë më e fortë se një e dukshme.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | |
|----|----|----|----|----|----|----|---|----|----|----|---|
| 8 | 4 | 1 | 2 | 5 | 4 | 6 | 5 | 3 | 4 | 1 | 4 |
| 1 | 2 | 8 | 1 | 5 | 8 | 4 | 7 | 10 | 6 | 2 | 3 |
| 10 | 6 | 7 | 2 | 7 | 11 | 6 | 2 | 1 | 4 | | |
| 10 | 7 | 15 | 1 | 12 | 1 | 2 | 3 | 4 | 10 | 1 | |
| 1 | 12 | 1 | 4 | 3 | 2 | 6 | 4 | 3 | 1 | 2 | |
| 4 | 2 | 6 | 11 | 3 | 2 | 6 | 4 | 3 | 1 | 14 | 3 |
| 1 | 2 | 4 | 16 | 2 | 7 | 16 | 6 | 18 | 1 | 4 | 4 |
| 1 | 2 | 8 | 3 | 14 | 3 | 1 | 1 | 1 | 1 | 1 | |
| 1 | 19 | 1 | 4 | 11 | 3 | 4 | 2 | 6 | 15 | C | |
| 8 | 1 | 5 | 4 | 18 | 6 | 2 | 1 | 4 | 3 | 2 | 6 |
| 5 | 16 | 1 | 10 | 6 | 4 | 3 | 4 | 6 | 3 | 18 | P |
| 10 | 3 | 15 | 3 | 18 | 6 | 14 | 8 | 14 | 1 | A | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| M | I | K | E | K | M | S | E | | | | |
| E | K | A | | R | O | M | A | K | E | T | |
| K | | M | I | L | I | T | A | N | T | E | T |
| | | M | A | T | E | M | A | T | I | K | A |
| P | A | S | A | N | I | K | T | S | | | |
| E | K | U | A | N | E | T | A | R | E | T | |
| R | E | T | E | E | I | R | A | N | I | | |
| I | T | R | B | L | A | K | E | L | | | |
| M | I | A | R | E | D | E | K | I | | | |
| E | | | M | E | T | A | L | E | I | S | |
| T | E | K | E | M | K | U | M | T | | | |
| M | O | R | A | V | I | A | M | A | E | | |

Thënie të mençura

- Prindërit më të dashur dhe të afërmit ju vrasin me buzëqeshjen e një gojë - Jim Morrison
- Rruga që shkon për sipër, është e njëjta rrugë që shkon për poshtë.
- Koha që shpenzon duke e shijuar, nuk është e humbur - John Lennon
- Gjetëm hirin. Mbetet të ri-gjejmë jetën, tani që nuk kemi më asgjë.

